



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 609 Akti

Nr. 654 Vendimi
Tiranë, më 28.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 27.4.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Nafije Hasko**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët Alma Faskaj relatore, Xhensila Pine kryesuese dhe Pamela Qirko anëtare.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer kontroll të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, duke krahasuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

6. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Nafije Hasko (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 10.1.2023, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Nafije Hasko.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive

profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

9. Në datën 13.4.2023, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

10. Në datën 18.4.2023, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë brenda datës 25.4.2023.

11. Në datën 20.4.2023 subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

12. Në datën 24.4.2023 subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike (me *email*) shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruara me dokumentacion.

13. Në datën 24.4.2023, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 27.4.2023, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

14. Në datën 27.4.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

16. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

17. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Nafije Hasko ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të

kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

24. Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

26. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

27. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 – 2016 dhe në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

28. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; si dhe (e) deklaratimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

29. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

30. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: z. B.H, bashkëshorti (bashkëshort nga data 25.11.2011) konsiderohet person tjetër i lidhur; z. N.C babai i subjektit dhe nëna e subjektit N.C, pasi kanë qenë në përbërje familjare me subjektin deri në momentin e lidhjes së martesës së saj, si dhe vëllai A.C konsiderohet person i lidhur për shkak se subjekti ka deklaruar të drejtën e përdorimit të automjetit në pronësi të tij.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar **apartament banimi me sip. 85.74 m² dhe garazh me sip. 18.76 m²**, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në posedim për shkak të martesës, blerë nga bashkëshorti në datën 29.7.2008. Pjesa takuese: 0%. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortit.

1.1 Bashkëshorti i subjektit me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2008, dhe kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 29.7.2008, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. ka fituar pronësinë përkatësisht mbi këto dy pasuri të deklaruara. Ai i ka deklaruar këto pasuri në DIPPV-në e vitit 2011, si person i lidhur i subjektit, pas lidhjes së martesës në datën 25.11.2011¹ me burim krijimi të ardhurat nga paga e tij.

1.2 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe/ose administratorët e saj. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 5 çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k., të cilat kanë përfunduar me vendimet: nr. ***, datë 6.3.2015; nr. ***, datë 29.4.2016; nr. ***, datë 2.3.2016; nr. ***, datë 2.2.2017; dhe nr. ***, datë 16.7.2020. Sa më sipër, subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për shkak se kontratat janë lidhur shumë kohë më parë se subjekti të lidhte martesë apo të fillonte bashkëjetesën me bashkëshortin B. H.

¹ Certifikatë martesë nr. *** akti, datë 25.11.2011.

1.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë apartament dhe garazh; (ii) këto pasuri janë fituar nga bashkëshorti përpara lidhjes së martesës me subjektin me të ardhura nga paga e tij përpara martesë; (iii) subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për shkak se kontratat janë lidhur shumë kohë më parë se subjekti të lidhte martesë apo të fillonte bashkëjetesën me bashkëshortin; (iv) subjekti nuk ka kontribuar në krijimin e tyre, për pasojë burimi i krijimit të tyre nga bashkëshorti është analizuar në vijim në pikën 3 të vendimit.

2. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar **automjet tip “****”**, me targë ***, në përdorim sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.10.2016, lëshuar nga pronari A.C.

2.1 Subjekti e deklaroi përdorimin e automjetit në deklaratën *Vetting*, si dhe në pyetësorin standard të procesit të rivlerësimit, duke saktësuar ndër të tjera se në periudhën prill 2012 – qershor 2012 ka përdorur automjetin tip “****”, me targë ***, në pronësi të vëllait të saj A.C, pasi i ka lënë atij në përdorim automjetin tip “ *** ”, me targë ***, në pronësinë e saj me qëllim shitjen e tij. Ky automjet është përdorur prej saj jo në përditshmëri, pasi në këtë periudhë ka qenë në shtëpi me leje lindje të vajzës D, e datëlindjes 7.1.2012, e cila ka zgjatur 1 vit. Në kushtet që shitja nuk u realizua pas një periudhe 3-mujore, vëllai i ka kthyer automjetin, të cilin deklaroi se e ka përdorur në vazhdim, sikundër i ka kthyer automjetin e tij. Ajo deklaroi në vijim se këtë automjet e ka përdorur edhe për periudhën nëntor 2016 – shkurt 2017, për shkak të nevojës që lindi për të siguruar nevojat personale për transport, pasi ka qenë në muajt e parë të shtatzënisë me fëmijën e dytë E.H, të datëlindjes 5.7.2017.

2.2 Subjekti rezultoi ta ketë pasur në përdorim këtë automjet me aktet noteriale: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2012, si dhe deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.10.2016.

2.3 Rezultoi e provuar se personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi A.C, ka blerë nga shoqëria “P” sh.p.k. automjetin tip “****”, me targë ***, në vlerën 18.000 euro, me faturë TVSH-je nr. ***, datë 30.12.2009. Aktualisht, ky automjet është regjistruar me targë ****³ dhe rezultoi të jetë importuar nga Kroacia në datën 16.11.2009, sipas deklaratës doganore me vlerë 14.784 euro dhe faturës së automjetit tip “****”, në Kroaci.

2.4 Në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së automjetit rezultoi e provuar⁴ se z. A.C ka kryer disa transaksione (depozitime *cash*) në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., pranë BKT-së, të cilat janë si vijojnë:

- Në datën 22.1.2010 derdh në llogari të shoqërisë “P” sh.p.k., me NIPT ***, vlerën 8.400 euro, me referencë transaksioni ***. Bashkë me përgjigjen përcillet mandatarkëtimi, ku përshkruhet si detaj “Fat. nr. ****”.
- Në datën 25.1.2010 derdh në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. me NIPT *** vlerën 470.000 lekë, me referencë transaksioni *** dhe përshkrim “Derdh në llogari për faturë nr. ****”.

² Sipas të dhënave në sistemin TIMS të përcjella me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2022, shtetasi A.C ka hyrë në territorin shqiptar në datën 20.12.2009 nga Porti i Durrësit dhe ka dalë në datën 9.8.2010.

³ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.11.2022, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.11.2022.

⁴ Shkresë “Përgjigje shkresës” nr. *** prot., datë 10.3.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.3.2023 dhe shkresa nr. *** prot., datë 21.3.2023, “Përgjigje shkresës”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.3.2023.

- Në datën 17.2.2010 derdh në llogari të shoqërisë “P” sh.p.k., me NIPT ***, vlerën 9.600 euro, me referencë transaksioni ***. Bashkëlidhur përgjigjes përcillet mandatarkëtimi, ku përshkruhet si detaj “Fat. nr. ****”.

2.4.1 Subjektit me pyetësin nr. 3 iu kërkuan sqarime dhe dokumentacion për veprimet bankare sa më lart rezultuar në BKT dhe shpjegime mbi vlerën e tyre, të cilat në total janë më të larta se vlera e blerjes së automjetit. Subjekti shpjegoi se: *“Në lidhje me këtë informacion dhe pyetjen tuaj ai deklaroi se nuk ka asnjë dijeni për këto veprime që pretendohen se janë kryer prej tij në këtë bankë në llogari të shoqërisë “P” sh.p.k. dhe se ai nuk ka kryer asnjë derdhje në bankë në llogarinë e shoqërisë “P” sh.p.k. për blerjen e mjetit. Vëllai deklaroi se ky automjet është blerë prej tij në datën 30.12.2009 nga shoqëria “P” sh.p.k. në shumën 18 mijë euro sipas faturës tatimore nr. ***, datë 30.12.2009, nr. serie *** dhe pagesa e kësaj shume është bërë prej tij me cash pranë shoqërisë “P” sh.p.k. Pas likuidimit të vlerës prej 18 mijë euro, ky mjet është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës në pronësi të tij në datën 6.1.2010. Në datën 15.1.2010 vëllai është larguar nga Shqipëria për në Itali dhe në datat respektive 21.1.2010, 22.1.2010 dhe 7.2.2010, që pretendohet që vëllai të ketë kryer derdhjet në bankë për shumat e cituara prej jush, ai nuk ka qenë në Shqipëri, fakt që ju mund ta verifikoni lehtësisht nga të dhënat e sistemit TIMS”.*

2.5 Nga sistemi TIMS⁵ rezultoi se shtetasi A.C ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në datën 20.12.2009 dhe ka dalë në datën 15.1.2010. Pra, rezulton se në datat e kryerjes së transaksioneve bankare (22.1.2010 – 17.2.2010) shtetasi A.C ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2.6 Në vijim të pyetësit nr. 3, pasi nga ana e Komisionit iu vendos në dispozicion kopje e informacionit bankar, subjekti shpjegoi se: *“...Pasi është njohur me përmbajtjen e tyre, si edhe të dokumentacionit bankar që ju më përcollët në vijim të komunikimit nëpërmjet emailit të dytë të datës 13.3.2023, vëllai deklaroi se nënshkrimi i hedhur në këto dokumente nuk është i tij. Me orientimin tim, vëllai i është drejtuar një eksperti privat për të kryer ekspertimin e këtyre dokumenteve, si edhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kallëzim penal për marrjen në përgjegjësi penale të personave të kallëzuar prej tij BKT, Dega Qendrore dhe shoqërisë “P” sh.p.k. për veprat penale “falsifikimit të dokumenteve” dhe “shpërdorimit të detyrës”, sipas neneve 186 e 248 të Kodit Penal, dokumentacion që po jua vë në dispozicion së bashku me përgjigjen⁶”.*

2.7 Në lidhje me vlerën e transaksioneve bankare në BKT, subjekti shpjegoi: *“Sa i përket çmimit të blerjes, referuar edhe përmbajtjes së kopjes së mandateve bankare konstatohet se derdhjet e kryera në datën 22.1.2010 në vlerën 8.400 euro dhe në datën 17.2.2010 në vlerën 9.600 euro, përputhen me:*

- i. shumën cash të paguar dhe të deklaruar nga vëllai;
 - ii. numrin e faturës tatimore nr. ***, datë 30.12.2009, të këtij transaksioni;
 - iii. shumën prej 18 mijë euro të paguar sipas kësaj fature.
- Ndërsa derdhja e datës 25.1.2010, e cila nuk ka as nënshkrim të personit që ka kryer derdhjen, sipas përshkrimit në fund të mandatit bankar i përket një fature tjetër tatimore me nr. *** dhe është në lekë jo në euro”.*

2.8 Nga AMF-ja (sistemi elektronik) konfirmohet se për vitin 2010 – 2011, në periudhën kur vëllai i subjektit rezulton se ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë, nuk

⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.10.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.10.2022.

⁶ Subjekti bashkëlidh me përgjigjet e pyetësit nr. 3: kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.3.2023, të BKT-së, Dega Qendrore; mandat bankar i BKT-së dublikatë (3 fletë), datë 22.1.2010, datë 25.1.2010 dhe datë 17.2.2010; akt ekspertimi grafik nr. ***, datë 17.3.2023 i ekspertit kriminalistik V. A. H. dhe kallëzim penal nr. *** prot., datë 16.3.2022, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga kallëzuesi A.C.

është prerë asnjë policë sigurimi për automjetin. Pra, duket se automjeti ka qenë i papërdorur, ndërsa pas kthimit të tij në Shqipëri në vitin 2012, periudhë pas së cilës ai është sistemuar dhe ka jetuar pa shkëputje rezulton se policat e sigurimit të automjetit janë prerë: A.C ka prerë policë sigurimi për automjet si pronar prej vitit 2012 – 2023; Nafije Hasko ka prerë policë sigurimi automjeti si përdorues në vitet 2012, 2014 – 2019 dhe në vitin 2021; B.H ka prerë policë sigurimi automjeti si përdorues në vitet 2012, 2014, 2016 – 2019 dhe 2021; A.C (bashkëshortja e A.C) ka prerë policë sigurimi si përdorues për vitin 2023.

2.8.1 Nga sistemi TIMS rezulton se as subjekti dhe as bashkëshorti i saj nuk e kanë përdorur këtë automjet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me burimin e krijimit

2.9 Me qëllim realizmin e një hetimi gjithëpërfshirës, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime me pyetësin nr. 2 në lidhje me burimin e krijimit të automjetit me targë ***, të cilin e ka pasur në përdorim të saj dhe në pronësi të vëllait të saj, z. A.C Subjekti shpjegoi se: *“...Sipas shpjegimeve të tij pagesa e kësaj shume është bërë cash pranë shoqërisë “P” sh.p.k. Burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat nga punësimi i vëllait si emigrant në shtetin italian...”*.

2.10 Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit pasqyrën e llogarisë së sigurimeve shoqërore të lëshuar nga Instituti Italian i Sigurimeve Shoqërore (INSP), që provon të ardhurat nga punësimi i të vëllait për periudhën 1996 – 2011 në shtetin italian. Sipas këtij dokumenti rezulton se shuma e të ardhurave të realizuara prej tij për vitin 2006 është 19.469 euro, ndërsa për vitin 2007 është 24.445 euro.

2.10.1 Subjekti ka shpjeguar më tej se këto të ardhura janë një pjesë e parave të dërguara prej vëllait në vitin 2007 në llogarinë e babait në “Raiffeisen Bank”, të cilat pas tërheqjes nga babai i saj janë mbajtur në shtëpi deri në blerjen e këtij automjeti.

2.11 “Raiffeisen Bank⁷” informon se në llogarinë e përbashkët të prindërve të subjektit janë transferuar vlera hyrëse me origjinë nga shteti italian nga shtetasi A.C, të cilat janë:

- në datën 28.6.2007 transferohet vlera 16.974.5 euro;
- në datën 31.10.2007 transferohet vlera 5.991 euro.

Këto vlera tërhiqen prej tyre si vijon:

- në datën 22.8.2007, vlera 6.974 euro;
- në datën 13.9.2007, vlera 5.000 euro;
- në datën 2.11.2007, vlera 200 euro;
- në datën 6.11.2007, vlera 2.800 euro;
- në datën 22.10.2008, vlera 7.400 euro.

2.12 Në lidhje me të ardhurat e vëllait nga emigracioni, subjekti, me pyetësin nr. 2, përcolli vërtetim nga INSP-ja (sigurimet shoqërore) në shtetin italian, për periudhën 1998 – 2011, në të cilin pasqyrohen edhe të ardhurat që ka realizuar gjatë kësaj periudhe.

2.13 Komisioni hartoi analizën financiare të shtetasit A.C për periudhën 2005⁸ – 2009, e cila është paraqitur në vijim, duke konsideruar shpenzimet jetike të tij sipas Eurostat-it⁹ të llogaritura për ditët e qëndrimit në këtë shtet, sipas të dhënave nga sistemi TIMS,

⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.3.2021, të “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

⁸ Nuk janë përfshirë në analizë të ardhurat e periudhës 1998 – 2004, pasi nuk kemi informacion mbi ditët e qëndrimit të tij në shtetin italian. Ndërsa shpenzime jetike të Eurostat-it janë referenca për çdo vit, të ardhurat e tij janë me baza ditore.

⁹ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/***/

ndërsa të ardhurat e përfshira në analizë i referohen të ardhurave të përcjella nga vërtetimi i sigurimeve shoqërore të përcjella nga subjekti.

Periudha	Akumulative për periudhën 2005 – 2009
Të ardhurat e vëllait nga emigracioni	128,409 euro
Shpenzimet jetike sipas Eurostat-it për ditët e qëndrimit në këtë shtet sipas sistemit TIMS	82,487 euro
Rezultati financiar	45,922 euro

2.13.1 Nga analiza e Komisionit rezultoi se shtetasi A.C ka pasur mundësi të krijojë vlerën e blerjes së automjetit (18.000 euro) me të ardhura të ligjshme.

2.14 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier¹⁰ dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë¹¹, nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit janë gjykuar çështje me shoqërinë “P” sh.p.k. Rezulton se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë shqyrtuar çështje gjyqësore me palë “P” sh.p.k.

2.15 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin përdorimin e këtij automjeti dhe nuk krijohen dyshime për të drejta të tjera të subjektit mbi këtë automjet; (ii) personi i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

A/3. DEKLARIMET E PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, Z. B.H

3. Apartament banimi me sipërfaqe 85.74 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, blerë në datën 29.7.2008. Vlera: 2.257.200 lekë. Pjesa takuese: 100%. **Garazh me sip. 18.76 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë**, blerë në datën 29.7.2008. Bashkëlidhur kopje e kontratës së shitblerjes dhe certifikatës së pronësisë. Vlera e garazhit: 393.960 lekë. Pjesa takuese e bashkëshortit: 100%. Burimi i krijimit për pasuritë e mësipërme: të ardhura nga paga¹².

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

3.1 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. B.H, në DIPP-në e vitit 2011, në të cilën ai i ka deklaruar të dyja pasuritë, ndërkohë ASHK-ja¹³ informon se në emër të tij figuron e regjistruar aktualisht vetëm pasuria me sip. 18.76 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit garazh me adresë në rrugën “****”.

3.2 Me kontratë shitblerjeje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2008, shtetasi B.H ka blerë nga shoqëria “G” sh.p.k., në vlerën 393.960 lekë, pasurinë e llojit garazh me sip. 18.76 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, në rrugën “****”, Tiranë. Pasuria sa më sipër është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 18.3.2015.

¹⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 16.2.2023 kthim përgjigje, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresa nr. *** prot., datë 21.3.2023, kthim përgjigje, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

¹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 10.2.2023 kthim përgjigje nga Gjykata Administrative Tiranë dhe shkresa nr.*** prot., datë 9.3.2023, kthim përgjigje, nga Gjykata Administrative Tiranë.

¹² Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së, përcillet certifikatë pronësie dhe kartelë pasurie për pasurinë nr. ***, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me sip. 85.74 m² dhe për pasurinë nr. ***, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me sip. 18.76 m² në pronësi të shtetasit B.H. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. **** kol., datë 29.7.2008, për blerjen e një apartamenti me numër pasurie nr. ***, me sipërfaqe të përgjithshme 95.27 m² në vlerën 2.257.200 lekë, të ndodhur në rrugën “****”. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2008, për blerjen e garazhit me numër pasurie nr. ***, me sip. 18.76 m² në vlerën 393.960 lekë.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021, nga DVASHK Tirana Veri.

3.3 Rezulton se pasuria apartament me sip. 85.75 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, aktualisht figuron e regjistruar në emër të shtetasve A.H dhe D.H, përkatësisht babai dhe motra e tij. Bashkëlidhur me përgjigjen, kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. *** kol., nr. *** rep., datë 5.7.2018, me palë shitëse B.H, dhënëse pëlqimi znj. Nafije Hasko, palë blerëse A.H (vjehri i subjektit të rivlerësimit) dhe D.H (motra e bashkëshortit) për shitjen e pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sip. 85.74 m² apartament banimi në vlerën 50.000 euro dhe kartela e pasurisë, sipas së cilës kjo pasuri rezulton e regjistruar në ASHK në datën 11.7.2018.

3.3.1 Në kontratat e shitblerjes së apartamentit¹⁴ dhe për garazhin është cituar se çmimi i blerjes i është shlyer blerësit jashtë zyrës noteriale.

3.4 FSHU-ja¹⁵ informon se në emër të shtetasit A.H, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent në kategorinë familjare në instancën Tiranë. Bashkëlidhur me përgjigjen, kontratë në emër të shtetasit A.H kabina “G”, e lidhur në datën 8.3.2006. UKT-ja¹⁶ informon se në emër të shtetasit A.H rezulton kontrata me nr. *** për objektin me adresë rruga “****”, me status aktiv.

3.5 Prej krahasimit të çmimit të blerjes së pasurive të mësipërme me referencat e EKB-së¹⁷ rezulton se vlera e apartamentit e blerë nga bashkëshorti i subjektit është 4.1 herë më e ulët se vlera e tregut të lirë të apartamenteve nga EKB-ja¹⁸ dhe vlera e garazhit, blerë nga bashkëshorti i subjektit është 1.4 herë më e ulët se kostoja mesatare e ndërimit nga EKB-ja¹⁹.

3.6 Komisioni iu drejtua shoqërisë “G” sh.p.k. për informacion dhe dokumentacion për pasuritë e mësipërme të z. B.H, në lidhje me mënyrën e likuidimit, kontrata ose marrëveshje paraprake, porosie, etj. Shoqëria përcjell²⁰ kontratën e shitblerjes së pasurive të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2008, për blerjen e apartamentit dhe kontratën e shitblerjes së pasurive të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2008, për blerjen e garazhit, të cilat ishin përcjellë më herët, me deklaratën *Vetting* në Komision nga subjekti.

Lidhur me burimin e krijimit

3.7 Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të pasurive apartament banimi me sip. 85.74 m² dhe garazh me sip. 18.76 m² “të ardhurat nga paga”. Në deklaratën *Vetting*, gjithashtu deklarohen të ardhurat e bashkëshortit, ku për periudhën deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, më 29.7.2008, për apartamentin deklarohen të ardhurat nga paga, shpërblimet si inxhinier në shoqërinë *** për periudhën qershor 2003 – prill 2008, shumat 45.700 USD dhe 16.500 euro, si dhe të ardhurat nga paga, shpërblimet si inxhinier në shoqërinë *** sh.p.k. për periudhën maj 2008 – gusht 2012, shumat 69.828 euro dhe 1.115.264 lekë.

3.8 Dokumentacioni që subjekti ka bashkëngjitur²¹, që provon këto marrëdhënie pune, përmban:

3.8.1 Kopje të kontratave të punës të lidhura nga data 1.6.2003 deri në datën 31.5.2008 me shoqërinë “****”; në kontratat e lidhura në periudhën qershor 2003 – maj 2008 rezulton se paga e bashkëshortit është dhënë bruto, me vlerë mujore nga 400 USD deri

¹⁴ Përcjellë nga subjekti me deklaratën *Vetting*.

¹⁵ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.3.2021, nga FSHU-ja, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.3.2021.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.4.2021.

¹⁷ Udhëzim Nr. 2, datë 4.4.2007 https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_2_04.04.pdf

¹⁸ 97.000 lekë/m² * 95.27 m² = 9.241.190 lekë.

¹⁹ 29.914 lekë/m² * 18.76 m² = 561.187 lekë.

²⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.2.2023.

²¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

në 1.950 USD. Referuar këtyre kontratave, detyrimi për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe tatimore i përket punëmarrësit. Nga vërtetimi datë 25.1.2017, i lëshuar nga likuidatori i shoqërisë, nuk përcillet informacion për të ardhurat nga paga pranë shoqërisë “***”. Prej datës 1.5.2008 deri në gusht të vitit 2012, kontrata për punësimin e tij është lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.

3.8.2 Ndërsa në kontratën e lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. në datën 1.5.2008, parashikohet paga mujore neto me vlerë 1.500 euro/muaj dhe detyrimi për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore/tatimore që i përket punëdhënësit. Me vërtetim page të datës 25.1.2017, likuidatori i shoqërisë “****” sh.p.k. me NIPT *** përcjell informacion mbi pagën dhe të ardhurat e përfituara prej tij për periudhën maj 2008 – gusht 2012, të cilat janë në vlerë totale prej 69.828 euro dhe 1.115.264 lekësh.

3.8.3 ISSH-ja²² përcjell në Komision informacion për bashkëshortin e subjektit, për të cilin janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore nga janari 2012 e në vijim.

3.8.4 Komisioni iu drejtua DPT-së²³ dhe Drejtorisë²⁴ Rajonale Tiranë për informacion në lidhje me pagesën e tatimit nga ana e bashkëshortit për periudhën qershor 2003 – dhjetor 2011, nga të cilat informohet se shoqëria “****” me NIPT *** është regjistruar në organin tatimor më 16.3.2011. Ndërsa për shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, listëpagesat për periudhën deri në dhjetor 2011 ndodhen pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

3.9 Me qëllim realizimin e një hetimi të plotë, subjektit i është kërkuar²⁵ të japë shpjegime në lidhje me shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara prej bashkëshortit të saj nga viti 2003 deri në vitin 2008, për të cilat sqaron se: *“Bashkëshorti im, z. B.H, gjatë periudhës së sipërcituar ka qenë i punësuar në shoqërinë ***, Gjermani ...Punësimi i tij në këtë pozicion pune ka qenë i lidhur me zbatimin e projektit të Bankës Botërore “Mirëmbajtja e rrugëve në Shqipëri” dhe të projektit “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit”, financuar nga Banka Gjermane KFW, projekte të cilat janë miratuar nga qeveria shqiptare... Për sa i përket detyrimeve tatimore, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 10, ka përcaktuar detyrimin e punëdhënësit për llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e tatimit mbi të ardhurat personale që lidhen me pagën apo shpërblimin që merr punonjësi... shoqëria punëdhënëse (punëdhënësi) ***, Gjermani, një shoqëri jo rezidente në Republikën e Shqipërisë, nuk ka pasur detyrimin për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në Republikën e Shqipërisë në lidhje me këto të ardhura”.* Subjekti përcjell, bashkëlidhur pyetësorit: shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2023, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, në të cilën vërtetohet se me shoqërinë “****” ka nënshkruar kontratë në datën 20.5.2003 nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve; shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2023, nga Ujësjetës-Kanalizime Pogradec; kontratën e nënshkruar midis shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****”; vërtetimin nr. *** prot., datë 13.11.2020, nga ISSH-ja për bazën e vlerësuar, për të ardhurat nga paga të z. B.H pas vitit 2012. Ndërkohë, nga Drejtoria e Arkivit Qendror²⁶ informohet se nuk disponon listëpagesa për subjektin “****” sh.p.k., me NIPT ***, përpara marsit të vitit 2011, por përcillet vërtetim për pagën neto të shtetasit B.H për periudhën maj 2008 – prill 2012.

²² Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga ISSH-ja, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2021.

²³ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.3.2023.

²⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.2.2023; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.2.2023; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2023.

²⁵ Shihni pyetësorin nr. 2.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2020, Drejtoria e Arkivit Qendror.

3.10 “Intesa Sanpaolo Bank²⁷” informon se sipas *statement*-it bankar të z. B.H, për periudhën 29.5.2008 – 3.7.2014, këtij të fundit i ka kaluar paga nga shoqëria “****” sh.p.k. me vlerë mujore duke nisur nga 1.289 euro. Pra, vlera e transfertave pranë “Intesa Sanpaolo Bank” përputhet me vlerat e pagës të përcjella nga vërtetimi i shoqërisë.

3.11 Nga hetimi rezultoi se të ardhurat nga paga të bashkëshortit të subjektit, deri në datën 29.7.2008, për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pra të konsideruara si të ardhura të ligjshme, kanë qenë në vlerën totale neto 183.474 lekë.

Ndërsa të ardhurat për periudhën qershor 2003 – maj 2008, kur bashkëshorti ishte i punësuar pranë shoqërisë “****”, nuk rezultoi e provuar pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga paga, ku, sipas kontratave të përcjella nga subjekti me deklaratën *Vetting*, përgjegjësia tatimore binte mbi vetë punëmarrësin, shtetasin B.H. Në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura nuk do të konsiderohen të ardhura të ligjshme, ndonëse u provua në mënyrë shteruese prej subjektit marrëdhënia e punësimit.

Vlerësimi i Komisionit

3.12 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se:

- Subjekti e ka deklaruar saktë këtë pasuri si në deklaratat periodike, edhe në atë *Vetting*.
- Pasuria nr. ***, apartament me sip. 85.74 m² dhe pasuria nr. *** garazh, me sip. 18.76 m², është krijuar nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit B.H, në vitin 2008, para martesës së tij me subjektin e rivlerësimit. Pavarësisht se personi i lidhur rezultoi me pamundësi financiare për të blerë pasuritë e mësipërme, me të ardhura të ligjshme rezultoi e provuar se subjekti nuk ka kontribuar ose marrë pjesë në krijimin e pasurive të tij.

4. Depozitë në BKT. Vlera: 40.055 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga²⁸.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

4.1 Lidhur me deklarimin në DIPP

- Në DIPP-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Llogari në BKT, tërheqje nga depozita në “ProCredit Bank” sh.a. dhe shtuar gjendjen cash sipas DPV/2012, datë 29.3.2013”*.
- Në DIPP-në e vitit 2017 ka deklaruar: *“Pakësim të depozitës në BKT, në datën 5.5.2017, në vlerën 40.059,48 euro, për efekt të shlyerjes së plotë të këstit të parë të kontratës së porosisë për blerje apartamenti me nr. ***, datë 3.5.2017. Pas këtij veprimi, kjo depozitë është mbyllur”*.

4.2 Në lidhje me transaksionet bankare për çeljen e depozitës së kursimit pranë BKT-së

BKT-ja²⁹ informon se shtetasi B.H ka llogari depozite në euro me nr. ***, të hapur në datën 27.10.2014, e krijuar nga derdhja *cash* në arkë e vlerës 28.000 euro me përshkrimin “Tërheqje nga llogari në bankë tjetër, bashkëlidhur mandati”. Ndërsa në

²⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.3.2021, e ISPB-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²⁸ Kontratë depozite bankare me BKT-në, e lidhur më 30.12.2014, me afat 3-mujor, për shumën 40 004.27 euro, në emër të z. B.H; vërtetim datë 23.1.2017, nga BKT-ja, për gjendje llogarie në vlerën 40.555,43 euro.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.3.2022.

datën 30.12.2014 derdh në llogarinë e tij edhe shumën 12.000 euro. Gjithashtu, prej përgjigjes së BKT-së konstatohet se depozita në monedhën euro e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është mbyllur në datën 5.5.2017 dhe, në të njëjtën datë (5.5.2017), ai transferon shumën e akumuluar prej 40.059,48 euro në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., sipas kontratës së porosisë për blerje apartamenti nr. ***, datë 3.5.2017.

4.3 Lidhur me burimin e krijimit të dy depozitimeve *cash*

4.3.1 Në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, ai ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 se si burim ka shërbyer tërheqja e vlerës së depozitës në “ProCredit Bank” dhe gjendja e kursimeve *cash*, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2012.

Burimi i depozitës në BKT	Vlera e deklaruar
Gjendja e llogarive në “ProCredit Bank” sh.a.	28 000 euro
Gjendja <i>cash</i> e deklaruar në DIPP/2012, tërhequr nga ISP Bank	12 000 euro
Totali	40 000 euro

4.3.2 Lidhur me depozitën e kursimit në “ProCredit Bank³⁰” sh.a. rezulton se z. B.H ka hapur llogari rrjedhëse me nr. ***, në datën 13.12.2008, në të cilën rezulton se kryeshin depozitime të herëpashershme nga motra e tij, znj. D.H, e cila ka qenë e punësuar³¹ pranë kësaj banke deri në prill 2015.

Ndërsa bashkëshorti i subjektit, në deklaratën e parë të plotësuar prej tij, DIPP-ja e vitit 2011, pas martesës (datë 25.11.2011), ka deklaruar: “Depozita “ProCredit Bank”, dega Tiranë, vlera 33.249 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga, bashkëlidhur vërtetimi i bankës, kontrata punësimi”. Prej *statement*-it të “ProCredit Bank” sh.a. rezulton se ka pasaktësi në deklarimin e tij në DIPP-në e vitit 2011, në lidhje me vlerën e depozitës së kursimit, pasi vlera e saj në fund të 2011 ka qenë 23.234,72 euro. Megjithatë, së bashku me vlerat e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit në euro në këtë bankë, të cilat janë në totalin prej 10.017 euro³², rezulton se vlera totale e likuiditeteve bankare të bashkëshortit në “ProCredit Bank” përputhet me vlerën e deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2011.

Komisioni hartoi analizën financiare të bashkëshortit të subjektit deri më 31.12.2011 për mundësinë e krijimit të vlerës totale të deklaruar prej tij 33.249 euro, e cila konfirmohet edhe prej informacionit të përcjellë prej *statement*-it bankar si gjendje në fund të vitit 2011.

Të ardhurat e përfshira në analizën e mëposhtme janë konsideruar të ardhurat nga paga e bashkëshortit në shoqërinë “****” sh.p.k. prej gushtit 2008³³ deri në dhjetor 2011. Vlerat e tyre janë konsideruar sipas vërtetimit të Drejtorisë së Arkivit Qendror³⁴ për pagën neto dhe shlyerjen e kontributit, përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 2, por për të cilat sipas kontratave të punës përgjegjësia tatimore bie mbi punëdhënësin.

Ndërsa provohet vlera e tyre nga *statement*-i i “Intesa Sanpaolo Bank”, ku transferoheshin vlerat e të ardhurave nga paga, të cilat për periudhën në shqyrtim janë si vijon:

	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011
Të ardhurat nga paga	13 707 euro	18 790 euro	21 609 euro	18 500 euro

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.3.2022.

³¹ Shihni shkresën e ISSH-së nr. *** prot., datë 9.11.2023, për shtetasen D.H.

³² Gjendja e llogarisë me nr. ***, në vlerën 3.015,98 euro dhe gjendja e llogarisë së kursimit me nr. *** është 7.000,93 euro.

³³ Të ardhurat për periudhën maj – korrik 2008 janë përjashtuar nga analiza financiare, pasi janë konsideruar si burim për pasuritë nr. ***.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2020.

<i>Ose të konvertuara</i>	<i>1 688 472 lekë</i>	<i>2 577 444 lekë</i>	<i>2 999 554 lekë</i>	<i>2 558 550 lekë</i>
Vlerat e tërhequra cash nga llogaria bankare prej z. B.H në total janë 84 965 euro	13 690 €	17 600 €	25 575 €	28 100 €

Duket se për derdhjet *cash* në llogarinë rrjedhëse pranë “ProCredit Bank” sh.a. të z. B.H kanë shërbyer tërheqjet nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”, me burim të ardhurat nga paga pranë shoqërisë “***”. Ndryshimi i gjendjeve të likuiditeteve pasqyron gjendjen e llogarive/depozitave të bashkëshortit në sistemin bankar gjatë periudhës gusht 2008 – dhjetor 2011, ku në fund të vitit 2011 gjendja e llogarive dhe depozitës së kursimit pranë “ProCredit Bank” është në total 33.262 euro.

Viti	Analiza financiare e akumuluar 1.8.2008 – 31.12.2011
Të ardhurat e bashkëshortit deri në dhjetor 2011	7 722 818 lekë
Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar	4 610 088 lekë
Shpenzimet jetike për një anëtar	466 785 lekë
Rezultati financiar	2 645 945 lekë

Nga analiza financiare e mësipërme rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë gjendjen pranë “ProCredit Bank” sh.a. deri në dhjetor 2011 me të ardhura të ligjshme, shuma e së cilës është përdorur më pas (vitit 2014) për krijimin e depozitës së kursimit pranë BKT-së. Gjendja e krijuar në fund të vitit 2011 pranë “ProCredit Bank” sh.a. rezulton të jetë krijuar me të ardhura të bashkëshortit para martese, për krijimin e të cilave subjekti nuk ka kontribuar.

4.3.3 Në lidhje me vlerën e kursimeve cash prej 12.000 euro, të deklaruar në deklaratat periodike, konstatohet së në DIPP-në e vitit 2012³⁵ bashkëshorti ka deklaruar: “Gjendje cash: 12 000 euro. Burimi i krijimit: Tërheqje nga depozita në “ProCredit Bank” dhe kursime të ardhurat nga paga (lëvizjet e llogarisë në bankën “ProCredit”, datë 21.3.2013. Gjendje e llogarisë bankare të “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.3.2013)”.

Ndërsa në DIPP-në e vitit 2014 deklaroi: “Llogari në BKT, dega Tiranë (tërheqje nga depozita në “ProCredit Bank” dhe shtuar gjendjen cash sipas DPV/2012, dorëzuar në datën 29.3.2012), vlera 40.004 euro”. Nga përgjigjet e “ProCredit Bank³⁶” dhe “Intesa Sanpaolo Bank³⁷” në Komision nuk rezultuan veprime bankare të kryera prej tij në këto data.

Subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, iu kërkua të sillte shpjegime për këtë deklaram, të cilat janë si vijon: “Shuma cash prej 12 mijë euro në vitin 2012 është krijuar nga tërheqja prej 5 mijë euro në datën 16.4.2012³⁸, nga depozita e tij në “ProCredit Bank”, depozitë e krijuar nga të ardhurat nga paga ndër vite të bashkëshortit, si dhe pjesa tjetër janë kursime nga të ardhurat nga paga e bashkëshortit për vitin 2012, të tërhequra nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank” në lekë, që të konvertuara janë 7 mijë euro”.

Gjithashtu, subjekti përcjell me pyetësorin nr. 2 kopje të mandatit bankar të

³⁵ Dorëzuar në ILDKPKI, në datën 29.3.2013.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 9.3.2021, protokolluar në Komision me numër *** prot., datë 19.3.2022.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, protokolluar në Komision me numër *** prot., datë 25.3.2021.

³⁸ Subjekti ka referuar gabimisht vitin e transaksionit nga 2012 në 2014, por përcjell dokumentin që provon gabimin material.

“ProCredit Bank” të datës 16.4.2012, ku z. B.H tërheq vlerën 5.000 euro nga llogaria e tij. Nga *statement*-i i “ProCredit Bank” rezulton se vlera e tërhequr ka qenë pjesë e depozitës së kursimit të hapur prej tij në datën 6.5.2010. Më lart (pika 4.1) është trajtuar mundësia financiare e bashkëshortit për të krijuar vlerën totale të gjendjes së llogarive të tij në “ProCredit Bank”, ku edhe vlera 5.000 euro, e tërhequr prej tij në datën 16.4.2012, është pjesë e këtij trajtimi.

Ndërsa nga *statement*-i i bankar i “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. rezulton se tërheqjet e bashkëshortit gjatë vitit 2012 nga kjo llogari kanë qenë në vlerën totale prej 1.107.500 lekësh ose, të konvertuara me kursin mesatar të vitit, 7.927 euro.

Sa më lart, rezulton se vlera e kursimeve prej 12.000 euro, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2012, ka burim tërheqjen në datën 16.4.2012 të vlerës 5.000 euro nga llogaria e bashkëshortit në “ProCredit Bank” dhe tërheqjet gjatë vitit 2012 nga llogaria e tij pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, me vlerë totale të konvertuar 7.927 euro.

Burimi i gjendjes së llogarisë në vitin 2012 pranë “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. provohet, pasi në këtë llogari transferohen pagat dhe shpërblimet e shoqërisë “****” sh.p.k., të cilat u provuan edhe prej Drejtorisë³⁹ Rajonale Tiranë, Drejtorisë së Arkivit Qendror⁴⁰ mbi pagën neto dhe vërtetimit për pagën neto nga likuidatori i “****”⁴¹ sh.p.k.

Vlerësimi i Komisionit

4.4 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se:

- Subjekti ka deklaruar saktë këtë likuiditet si në DIPP, edhe në atë *Vetting*.
- Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme vlerën e depozitës së kursimit në BKT gjatë vitit 2014 me vlerë totale 40.555 euro.

5. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”. Vlera: 973.463 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

5.1 Deklarimet periodike

5.1.1 Në DIPP-në e vitit 2014 personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka deklaruar: “Llogari në “Raiffeisen Bank”, dega ***, të ardhura nga pagat për periudhën 15 shkurt 2014 – 30 tetor 2014, vlera 2.291.578 lekë”. Në DIPP-në e vitit 2015 bashkëshorti deklaroi: “Gjendje llogarie në “Raiffeisen Bank” në datën 31.12.2015, vlera 2.312.098 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2016 bashkëshorti deklaroi: “Gjendje llogarie në “Raiffeisen Bank” në datën 31.12.2016, vlera 803.121 lekë. “Raiffeisen Bank”, nr. llogarie ***”.

5.2 “Raiffeisen Bank”⁴² sh. a. informon se z. B.H disponon llogari page me nr. ***, të çelur në datën 28.2.2014, me gjendje llogarie në datën 31.12.2016 në shumën 803.124 lekë. Rezulton se në këtë llogari të bashkëshortit janë transferuar të ardhurat nga paga nga shoqëria “****” sh.p.k. prej datës 4.3.2014 deri në datën 31.10.2014, me

³⁹ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.2.2023; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.2.2023; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.2.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2023.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2020.

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2017, dosja e ILDKPKI-së, aneks nr. ***.

⁴² Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.3.2021, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

vlerë totale 2.370.961 lekë. Ndërsa prej datës 4.9.2015 deri më 9.1.2017 i transferohen pagat nga shoqëria “****” sh.p.k., me vlerë totale të ardhurash nga kjo shoqëri në shumën 3.117.156 lekë.

5.2.1 Gjithashtu, në këtë llogari, në datën 30.12.2014, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 1.700.000 lekë me përshkrimin “B.H derdh të ardhura nga paga, profesioni ing. ndërtimi”. Rezulton se në periudhën mars 2014 – shtator 2014 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr *cash* vlerën 1.735.000 lekë nga kjo llogari page, ndërsa vlera e të ardhurave nga paga gjatë të njëjtës periudhë ka qenë 2.370.975 lekë.

5.2.2 Në DIPP-në e vitit 2014 deklararon: “Llogari në “Raiffeisen Bank”, dega *** (të ardhura nga pagat për periudhën 15 shkurt 2014 - 30 tetor 2014), vlera 2.291.578 lekë. Të ardhurat nga paga shpërblime si inxhinier në shoqërinë “****” sh.p.k. për periudhën 10 shkurt 2014 deri më 30 tetor 2014. Vlera: 2.370.961 lekë”. Në deklaratën Vetting deklararon: “Të ardhura nga paga, shpërblime si inxhinier në shoqërinë “****” sh.p.k. për periudhën shkurt 2014 – tetor 2014. Shuma 2.371.322 lekë”. Shuma e derdhur *cash* në fund të vitit 2014 ka burim tërheqjet nga paga të transferuara në llogarinë e bashkëshortit pranë “Raiffeisen Bank” sh.a. gjatë vitit 2014.

5.3 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁴³ dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁴⁴ në lidhje me administratorët dhe/ose ortakët e shoqërive pranë të cilave ka pasur marrëdhënie pune dhe informohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështje administrative me këto shoqëri dhe/ose administratorët dhe ortakët e tyre.

Vlerësimi i Komisionit

5.4 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se:

- Përputhet deklarimi i personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, me dokumentacionin e përcjellë dhe administruar nga institucionet në Komision.

6. Depozitë në “Raiffeisen Bank”. Vlera: 3.000.127 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

6.1 Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur deklararon: “Depozitë në “Raiffeisen Bank” Vlera: 3.000.127 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga. “Raiffeisen Bank”, dega Tiranë, kontrata nr. ref. ***, datë 22.6.2016”.

6.2 “Raiffeisen Bank” sh.a.⁴⁵ informon se shtetasi B.H ka çelur depozitë kursimi në datën 29.2.2016, duke transferuar vlerën 2.502.000 lekë prej llogarisë së tij rrjedhëse dhe në datën 22.6.2016 ka transferuar edhe vlerën 497.982 lekë prej të njëjtës llogari. Vlera totale është 3.000.064 lekë, me burim transfertat e kryera nga bashkëshorti prej llogarisë së tij të pagës, e cila është mbyllur si depozitë kursimi.

6.3 Ndërsa në lidhje me burimin e gjendjes së llogarisë rrjedhëse të bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, e cila është trajtuar më lart (pika 5), rezulton se si burim i gjendjes së krijuar në këtë llogari kanë shërbyer vlerat e të ardhurave të tij nga paga në shoqëri

⁴³ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.2.2023, e Gjykatës Administrative Tiranë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.3.2023, e Gjykatës Administrative Tiranë.

⁴⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.3.2021, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

private dhe derdhja *cash* e kryer nga bashkëshorti me vlerë 1.700.000 lekë, analizuar në pikën 1.

Vlerësimi i Komisionit

6.4 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se:

- Subjekti ka deklaruar saktë këtë depozitë si në deklaratat periodike, edhe në atë *Vetting*.
- Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme vlerën e depozitës së kursimit me të ardhura të ligjshme nga paga e tij.
- Përputhet deklarimi i personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, me dokumentacionin e përcjellë dhe administruar nga institucionet në Komision.

A/4. GJETJE TË TJERA

7. Subjekti në DIPP-në e vitit 2003 ka deklaruar: “*Shtëpi banimi 3-katëshe me sipërfaqe 190 m², në Kavajë. Pjesa takuese: 25%. Burimi: të ardhurat e përbashkëta të familjes dhe emigracioni i vëllait*”. Pas këtij deklarimi, subjekti nuk e deklaroi më në deklaratat pasuese këtë pasuri.

7.1 Në procesverbalin e datës 14.1.2015, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti, pasi është pyetur nëse është regjistruar kjo banesë, si dhe për burimin e krijimit të shtëpisë dhe vlerën e kësaj shtëpie, pasi nuk është deklaruar, ka shpjeguar se deklarimi i parë për këtë pasuri është bërë në kohën kur nisi edhe procedura e deklarimit për këtë shtëpi, e cila faktikisht dhe juridikisht ka qenë në atë kohë në pronësi të babait të saj XH.H dhe, për pasojë, deklarimi i pjesës është përcaktuar sipas pjesës si trashëgimtare e tij.

7.2 Komisioni, duke konstatuar deklarimin e subjektit në DIPP për këtë pasuri, hetoi lidhur me saktësinë e deklarimit të saj dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

7.3 Nga konsultimi me arkivin dixhital të pasurive të paluajtshme (sistemi IPS), rezulton se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, me kontratë nr. ***, datë 13.12.1996, ka blerë nga shtetasi K.K pasurinë “shtëpi banimi përbërë nga dy dhoma, sallon, verandë depo e banjë ...”⁴⁶ në vlerën 700.000 lekë.⁴⁷ Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Kavajë me vërtetimin hipotekor nr. ***, datë 7.11.2003, me nr. pasurie ***, z. k. ***, truall me sip. 52.5 m².

7.4 Me vendimin nr. ***, datë 18.9.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në të cilin paditësi XH.C ka kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë mbi truallin nga shtetasit Y.I, A.I dhe F.I, dalin fakte që kanë të bëjnë me mënyrën e fitimit të pronësisë për truallin, mbi të cilin është ndërtuar kjo banesë. Gjykata vëren se palët kanë lidhur kontratë shitblerjeje, shkresë e thjeshtë e datës 5.10.1969, ku të paditurit shtetasit I i kanë shitur shtetasit XH.C kundrejt vlerës 7.000 lekë një shtëpi banimi të përbërë nga dy dhoma dhe depo. Në vijim të këtij vendimi gjykate është lëshuar vërtetim hipotekor nga dokumenti hipotekor nr. ***, vol. i parë ***, datë 14.11.2001, sipas të cilit rezulton se ka regjistruar pasurinë me nr. ***, ndodhur në z. k. ***, me sipërfaqe trualli 114 m², me pronar z. XH.C.

⁴⁶ Mbetet e paqartë nëse kjo banesë është rikonstruktuar ose shembur, pasi në vendimin e zgjidhjes së çështjes me pajtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, nr. ***, datë 20.9.2002, për këtë kontratë referohet objekti i saj “Truall me sip 61 m²”.

⁴⁷ Duket se kjo pasuri e referuar në vendimin e zgjidhjes së çështjes me pajtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, nr. ***, datë 20.9.2002, “Truall me sip. 61 m²”, është regjistruar në ZVRPP-në Kavajë pas matjeve në terren (plan rievimi) si pasuri truall me sip. 52.5 m². Referojuni vendimit të ZVRPP-së Kavajë, vendim nr. s’ka, datë s’ka 2002, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në bazë të nenit 24/b”, bashkëlidhur praktikës nga sistemi IPS (posedim mbi 12 vjet).

7.5 Gjithashtu, në dokumentacionin e gjendur në sistemin IPS, rezulton se në aktin e datës 2.2.2001 të kolaudimit tekniko - ekonomik, të hartuar nga ing. B.D, përcaktohet afati i ndërtimit prej 11 muajsh, respektivisht periudha shtator 1998 – gusht 1999. Firma e ndërtimit e kontraktuar për kryerjen e punimeve nga z. XH.C ka qenë shoqëria “****” sh.p.k. dhe vlera faktike e punimeve të objektit, sipas aktit të kolaudimit, është 8.000.000 lekë. Bashkëlidhur miratimi me vendim nr. ***, datë 30.5.1997, të KRRT-së pranë rrethit Kavajë, të sheshit të ndërtimit, kurse leja e ndërtimit është dhënë në zbatim të vendimit nr. ***, datë 25.9.1998, të KRRT-së pranë rrethit Kavajë. Ndërsa është pajisur me leje shfrytëzimi në datën 29.6.2004, për objektin rikonstruksion i banesës ekzistuese në Lagjen nr. ***, Kavajë, sipas sheshit dhe projektit të miratuar nga këshilli bashkiak dhe KRRT-ja e rrethit Kavajë + ngritje 2-katësh, me investitor XH.C, në një sipërfaqe ndërtimi 166.5 m² dhe sipërfaqe ndërtimi të katit përdhe 160 m², të katit të parë, të dytë, përkatësisht 175 m² secila.

7.6 Shtetasi XH.C është pajisur me vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, vol. ***, datë 19.7.2004, sipas të cilit rezulton se ka regjistruar pasurinë me nr. ***, ndodhur në z. k. ***, me sipërfaqe trualli 166.5 m².

7.7 Nga konsultimi me arkivin dixhital, rezulton se aktualisht kjo pasuri është e regjistruar nën emrin e pronarëve N.C, A.C dhe Nafije Hasko, ndërsa nga regjistri noterial⁴⁸ duket se është çelur dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 25.9.2021.

7.8 Subjekti përcjell me pyetësin nr. 3 në Komision kartelën e pasurisë “Godinë e kombinuar 3 kate soc-ekonomik 163.2 m², kati i parë 166 m² dhe kati i dytë 166 m²”, me nr. pasurie ***, z. k. ***, ku subjekti rezulton pronar me 1/6 e pjesës takuese, z. A.C pronar me 1/6 e pjesës takuese dhe nëna e tyre me 4/6 e pjesës takuese.

7.9 Sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika të kësaj pasurie, që lidhen me procesin e rivlerësimit.

Lidhur me burimin e ligjshëm

7.10 Subjekti deklaron në DIPP-në e vitit 2003 se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e përbashkëta të familjes dhe ato nga emigracioni i vëllait. Me pyetësin nr. *** sqaron se kjo banesë është ndërtuar me të ardhurat e realizuara prej prindërve dhe të ardhurat e vëllait nga emigracioni në shtetin italian. Për periudhën 1992 – fundviti 2001, prindërit kanë ushtruar aktivitet privat si tregtarë ambulantë, shitje ëmbëlsirash në qytetin e Kavajës dhe të gjitha kursimet nga këto të ardhura janë investuar në ndërtimin e banesës. Ajo shpjegon se këtë aktivitet e ka trashëguar edhe vëllai, aktivitet të cilin e zhvillon aktualisht. Burimi kryesor i të ardhurave në këtë investim i përket vëllait, i cili ka emigruar në Itali nga viti 1993 deri në vitin 2011. Ligjshmëria e të ardhurave të vëllait nga emigracioni është analizuar në pikën 1 të këtij vendimi.

7.11 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se:

- Rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur kontribut në ndërtimin e kësaj banese dhe pjesa takuese e saj derivon pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit, babait të saj.
- Prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe vëllai kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të ndërtuar objektin 3 kate në qytetin e Kavajës.

⁴⁸ Vendosur në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.10.2022.

8. Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Autoveturë “***”, me targë ***, blerë në vlerën 0.2 milionë lekë, me kontratë shitblerjeje në vitin 2003, me të ardhurat nga paga”.

8.1 DPSHTRR-ja⁴⁹ informon se nga verifikimet e bëra në emër të subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar mjeti me targë ***. Sipas dokumentacionit, rezulton se:

8.1.1 Subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. ***, datë 24.7.2003, ka blerë nga shtetasi A.C, vëllai i saj, mjetin “***”, ngjyrë gri, vit prodhimi 1999, me numër shasie ***, me targë ***, në vlerën 200.000 lekë. Subjekti është pajisur me leje qarkullimi për mjetin “***”, ngjyrë gri, vit prodhimi 1999, me numër shasie ***, me targë ***.

8.1.2 Sipas deklaratës doganore, rezulton se mjeti është importuar nga shteti italian nga shtetasi A.C, në datën 22.7.2003, në vlerën 459.748 lekë. Mjeti është blerë nga ky i fundit në shtetin italian, në datën 12.6.2003, në vlerën 3.400 euro. Rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin prej vëllait të saj A.C dhe në këtë marrëdhënie të posaçme vlera e blerjes nga subjekti i rivlerësimit është më e ulët (200.000 lekë) sesa vlera e blerjes nga vëllai A.C në shtetin italian (459.748 lekë).

Lidhur me burimin e krijimit

8.2 Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat nga paga. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës prej vitit 1999, gjatë së cilës është trajtuar me bursë dhe në periudhën e stazhit profesional tetor 2001 – tetor 2002 ka përfutur pagë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke konsideruar sa më lart, është kryer analiza financiare për blerjen e automjetit nga subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e saj nga paga, e cila është si vijon:

Analiza financiare	1.1.2003 - 24.7.2003
Të ardhurat nga paga e subjektit	301,620 lekë
Vlera e blerjes së automjetit	200,000 lekë
Shpenzimet jetike për 1 anëtar	62,643 lekë
Rezultati financiar	38,977 lekë

Duket se subjekti ka pasur mundësi të blejë automjetin me të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2003 deri në datën e blerjes së tij.

8.3 Në përfundim, trupi gjyqësor çmon se:

- Nuk u paraqitën problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.
- Subjekti ka pasur mundësi të blejë automjetin me të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2003 deri në datën e blerjes së tij.

9. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit⁵⁰ se në bazë të kontratës noteriale të huapërdorjes nr. ***, datë 7.12.2017, ajo dhe bashkëshorti kanë të drejtë përdorimi si brenda edhe jashtë shtetit të mjetit “***” me targë ***, në pronësi të znj. D.H, motra e z. B.H, bashkëshortit të subjektit. Kjo kontratë është autorizim përdorimi pa afat të përcaktuar dhe është bërë e tillë për të lehtësuar përdorimin e këtij mjeti sipas nevojave të të dyja familjeve.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2021.

⁵⁰ Kthim përgjigjeje pyetësor nr. 1, pyetja nr. 7.

9.1 Si pasojë e këtij deklarami, pavarësisht se bëhet fjalë për një të drejtë përdorimi pas deklaratës *Vetting*, trupi gjykues çmoi se z. D.H (motra e bashkëshortit) është person tjetër i lidhur, në kuptim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për pasojë, Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare mbi mundësinë që shtetasja D.H ka pasur për të blerë këtë automjet me të ardhura të ligjshme.

9.2 Nga informacioni i administruar⁵¹, rezulton se me kontratë shitjeje nr. ***, datë 8.11.2017, shoqëria “L” sh.a. i ka shitur shtetasen D.H mjetin e llojit “****” me targë ***, me nr. shasie ***. Në përmbajtje të kontratës, në pikën 2, konstatohet se midis palëve është lidhur një kontratë e mëparshme qiraje financiare me nr. ***, datë 15.2.2013.

Lidhur me burimin e krijimit

9.3 Znj. D.H⁵² prej janarit të vitit 2012 deri në prill 2015 ka punuar pranë “ProCredit Bank” sh.a. dhe prej nëntorit 2015 deri në gusht të vitit 2022 pranë “Union Bank” sh.a. Me kontratat nr. ***, nr. ***, datë 15.2.2013, provohet marrëdhënia e saj financiare me shoqërinë “L⁵³” sh.a., ku çmimi i blerjes së automjetit është në shumën 7.600 euro, vlera e parapaguar 2.000 euro dhe shuma e financuar prej “L” sh.a. 5.600 euro (afat 60 muaj). Në të njëjtën kohë, nga provat rezulton se edhe shlyerja e kësteve të kredisë-*leasing* nga shtetasja D.H është transferuar nga llogaria e saj në “ProCredit Bank” sh.a. prej datës 1.3.2013 deri më 3.11.2015 dhe, pas kësaj date deri më 7.11.2017, kur është shlyer kredia, janë transferuar nga llogaria e saj në “Union Bank”. Gjithashtu, pagesat e kësteve të *leasing* prej shtetasen D.H konfirmohen edhe nga “ProCredit Bank⁵⁴” sh.a. dhe “Union Bank⁵⁵” sh.a., ku kjo shtetase ka qenë e punësuar.

9.4 Në përfundim, trupi gjykues çmon se:

- Znj. D.H e ka blerë automjetin e mësipërm me të ardhurat nga kredia-*leasing*, e cila është shlyer më pas prej të ardhurave nga paga që kalon në llogarinë e saj bankare.
- Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri për procesin e rivlerësimit.

10. Gjatë hetimit, subjekti, e pyetur⁵⁶ mbi blerjet/investimet/shpenzimet me vlerë më të lartë se 2.000 euro, që nga dorëzimi i deklaratës *Vetting*, ka shpjeguar se: “*Sipas kontratës nr. ***, datë 3.5.2017, me palë blerëse B.H dhe shitës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe kontratës së shitjes nr. ***, datë 5.11.2020, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. dhe palë blerëse B.H dhe Nafije Hasko, kam blerë apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, pallati “****”, hyrja ***, kati ***, ap. ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, në vlerën 109.000 euro*”.

10.1 Rezultoi e provuar se kjo pasuri është fituar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj pas deklaratës *Vetting*. Në përputhje më kuadrin ligjor të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi të bëjë një analizë të detajuar të burimit të krijimit të kësaj pasurie.

10.2 Me kontratën e porosisë nr. ***, datë 3.5.2017, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit B.H është bërë porositja e apartamentit me nr. ***, me sipërfaqe totale 174.7 m², nga e cila 157.6 m² sipërfaqe apartamenti, plus 17.1 m² sipërfaqe e përbashkët e shkallës, me adresë: rruga “****”, Tiranë, me çmim të shitjes së

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 11.11.2022.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2022, e ISSH-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.11.2022.

⁵³ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.11.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.11.2022.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2022, e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.11.2022.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2022, e “Union Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.11.2022.

⁵⁶ Kthim përgjigjeje, pyetja nr. 20, pyetësori nr. 1.

apartamentit në vlerën 109.000 euro. Në vijim, rezulton e provuar se midis palëve të mësipërme është lidhur kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 5.11.2020.

Lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të apartamentit

10.3 Kësti i parë në vlerën 42.000 euro, në kontratë, është parashikuar të paguhej brenda datës 8.5.2017. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2017 se është pakësuar depozita në BKT në datën 5.5.2017 në vlerën 40.059 euro, për efekt të shlyerjes së plotë të këstit të parë të kontratës së porosisë për blerjen e apartamentit. BKT-ja⁵⁷ informon se depozita e kursimit në euro, me nr. ***, e trajtuar në pikën 4 të rezultateve, rezulton se është maturuar më 5.5.2017 dhe vlera e saj është transferuar po në këtë datë në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k.

10.3.1 Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2017, bashkëshorti i subjektit deklaron pakësim të llogarisë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në datën 5.5.2017, në vlerën 268.021 lekë, e konvertuar në 1.941 euro, për efekt të shlyerjes së plotë të këstit të parë të kontratës së porosisë për blerjen e apartamentit. Nga komunikimi me “Raiffeisen Bank⁵⁸” rezulton se gjendja e llogarisë rrjedhëse në lekë, e trajtuar në pikën 5 të rezultateve, e krijuar nga transferimi i të ardhurave nga paga e z. B.H në datën e pagesës së këstit, 5.5.2017, është 1.023.272,19 lekë. Z. B.H ka konvertuar në monedhën euro dhe më pas ka transferuar nëpërmjet bankës vlerën 1.941 euro (ose 268.021 lekë) drejt llogarisë së shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin: “B.H kalim në llogari, sipas kontratës së porosisë për blerje apartamenti nr. ***, datë 3.5.2017, notere M.D”.

Kësti i parë	Vlera e pagesës	Burimi
42 000 euro	40 059.48 euro	Depozita në BKT e bashkëshortit
	1 941 euro	Gjendja e llogarisë rrjedhëse në RBAL e bashkëshortit
Totali	42 000,48 euro	

10.3.2 Rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në rr. “****”, Tiranë.

10.4 Kësti i dytë në vlerën 30.000 euro, në kontratë është parashikuar të paguhej brenda nëntorit 2017. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2017 se është pakësuar depozita në “Raiffeisen Bank” në datën 1.12.2017 në vlerën 3.000.320,7 lekë dhe është pakësuar gjendja e llogarisë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në datën 1.12.2017, në vlerën 1.009.300 lekë, për efekt të shlyerjes së plotë të këstit të dytë të kontratës së porosisë për blerjen e apartamentit.

Nga komunikimi me “Raiffeisen Bank⁵⁹”, rezulton se gjendja e llogarisë rrjedhëse të bashkëshortit deri në datën 1.12.2017 ka qenë 1.200.425 lekë, me burim akumulimin e të ardhurave nga paga e tij, ndërsa gjendja e depozitës së kursimit ka qenë 3.000.369,83 lekë, burimi i së cilës është analizuar në pikën nr. 6 të vendimit. Pasi është prishur depozita para maturimit dhe bashkuar me vlerën e transferuar nga llogaria rrjedhëse prej 1.009.300 lekësh, totali i tyre me vlerë 4.009.669,83 lekë (ose 30.000 euro) është transferuar në llogarinë e shoqërisë me përshkrimin: “Kalim sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2017, notere M.D, kurs euro 133.64”.

Kësti i dytë	Vlera e pagesës	Burimi
30 000 euro	3 000 369,83 lekë	Depozita pranë RBAL e bashkëshortit
	1 009 300 lekë	Gjendja e llogarisë rrjedhëse në RBAL e bashkëshortit
Totali	4 009 669,83 lekë ose 30 000 euro	

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.3.2022.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2021, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

10.4.1 Sa më sipër, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi të shlyejë pagesën e këstit të dytë me të ardhura të ligjshme dhe në përputhje me deklaratimet e tij.

10.5 Për këstin e tretë në vlerën 37.000 euro, në kontratë, palët kanë rënë dakord se do të paguhet me marrjen në dorëzim të apartamentit, parashikuar brenda muajit mars 2018. Në DIPP-në e vitit 2018, bashkëshorti deklaroi pakësim të llogarisë rrjedhëse të tij në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 30.000 euro, në datën 27.9.2018 dhe në vlerën 5.000 euro, në datën 15.11.2018, për efekt të shlyerjes së plotë të këstit të tretë të kontratës së porosisë për blerjen e apartamentit.

Gjithashtu, ai deklaroi në DIPP-në e vitit 2018 se është shitur apartamenti me sip. 85.74 m², i ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, sipas kontratës nr. ***, datë 5.7.2018, në vlerën 50.000 euro. Kopja e kësaj kontrate përcillet nga subjekti i rivlerësimit bashkë me pyetëtorin standard.

“Raiffeisen Bank⁶⁰” informon se shuma 755.850 lekë dhe vlera 43.998,8 euro, me burim shitjen e apartamentit në rrugën “***”, është transferuar nga llogaria e noteres R.D me përshkrimin: “Kont. shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.7.2018”. Nga vlera e transferuar shuma 30.000 euro është transferuar në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k. në datën 27.9.2018 dhe shuma 5.000 euro në datën 15.11.2018. Gjithashtu, edhe vlera e mbetur prej 2.000 euro nga çmimi total 109.000 euro është likuiduar në datën 12.4.2019, me burim gjendjen e mbetur në llogarinë e tij nga vlera e shitjes së apartamentit në rrugën “***”, Tiranë.

Rezulton se vlera e plotë e këstit të tretë prej 37.000 euro është likuiduar nga vlera e shitjes së apartamentit në rrugën “***”, Tiranë.

10.6 Në lidhje me burimin e të ardhurave nga shitja e apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, pas analizës financiare të realizuar nga Komisioni, nuk rezultuan problematika lidhur me procesin e rivlerësimit të subjektit.

10.7 Komisioni hetoi gjithashtu lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁶¹ dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁶², nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit janë gjykuar çështje me palë shoqërinë “***” sh.p.k, ortakët e saj dhe/ose administratorët e saj. Nga informacioni i ardhur nuk ka çështje gjyqësore me palë shoqërinë “***” sh.p.k., ortakët dhe/ose administratorët e saj, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit.

11. Nga BKT-ja⁶³ rezultoi se në llogarinë e përbashkët të prindërve të subjektit, XH.C dhe N.C, me nr. ***, në datën 25.8.2010 është transferuar shuma 49.950 euro. Prej vlerës së transferuar, shuma 40.000 euro është mbyllur si depozitë kursimi deri në shtator 2012, ndërsa vlera 9.950 euro është tërhequr *cash* në datën 31.8.2010. Në shtator 2012, vlera 21.374 euro tërhiqet *cash* nga llogaria, ndërsa 20.000 euro rimbyllet në depozitë, me afat deri në mars 2013. Pas këtij momenti, vlera e saj reduktohet herë pas here nga tërheqjet *cash* dhe pjesa e mbetur mbahet si depozitë kursimi deri në nëntor 2014, kur tërhiqet edhe vlera e mbetur në atë moment prej 10.034 euro dhe llogaria mbyllet.

11.1 Gjithashtu, nga “Raiffeisen Bank⁶⁴” rezulton se në datën 28.5.2007 është transferuar shuma 16.974,5 euro në llogarinë e z. XH.C prej z. A.C (transfertë nga jashtë) dhe në datën 31.10.2007 është transferuar edhe shuma 5.991 euro. Vlera 15.574

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2021, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

⁶¹ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁶² Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.2.2023, e Gjykatës Administrative Tiranë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.3.2023, e Gjykatës Administrative Tiranë.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.3.2022.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2021 protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.3.2021.

euro është tërhequr *cash* nga të dy prindërit e subjektit, ndërsa vlera e mbetur prej 7.400 euro ka qëndruar në llogarinë rrjedhëse deri në datën 22.10.2008, kur tërhiqet nga z. XH.C.

11.1.1 Në lidhje me vlerat e cituara më lart, me burim transfertat nga vëllai, subjekti shpjegon me pyetësorin nr. 2 se “*Burimi i krijimit të shumave të transferuara në BKT dhe “Raiffeisen Bank” nga vëllai te llogaria e prindërve janë të ardhurat nga puna si emigrant në shtetin italian*”, duke sqaruar se të dyja shumat e transferuara në “Raiffeisen Bank” në vitin 2007 janë tërhequr nga babai dhe janë ruajtur prej tij në shtëpi sipas porosive të vëllait. Nga kjo shumë parash, shuma prej 18 mijë euro është shpenzuar nga vëllai në dhjetor të vitit 2009 për blerjen e automjetit tip “****”, me targë ***, në pronësi të tij, ndërsa pjesa tjetër është ruajtur në shtëpi në formën e kursimeve. Analiza e këtyre llogarive është analizuar në pikën 2 të vendimit.

11.2 Ndërsa për shumën e transferuar në BKT në datën 25.8.2010, subjekti shpjegon se shuma 49.950 euro është e gjitha nga kursimet e të vëllait prej të ardhurave të punësimit të tij në Itali, të mbajtura prej tij ndër vite në të njëjtën bankë, deri në datën e transferimit të tyre. Transferimi i të gjithë shumës ka ndodhur, pasi vëllai në këtë kohë nisi përgatitjet për t’u kthyer dhe për të jetuar në Shqipëri. Pas transferimit të kursimeve, vëllai është kthyer në Shqipëri në datën 28.11.2010, ku ka qëndruar për më pak se 1 vit. Në datën 2.10.2011, ai ka ikur në Itali, ku ka punuar për një periudhë rreth dy muaj e gjysmë dhe është pajisur me lejen e qëndrimit pa afat dhe është kthyer përfundimisht në datën 17.12.2011. Sipas shpjegimeve të vëllait, shuma 49.950 euro është tërhequr nga prindërit sipas porosisë së tij dhe është ruajtur në shtëpi prej babait deri në kthimin e tij në Shqipëri. Më pas, një pjesë e kësaj shume është shpenzuar nga vëllai për të hapur aktivitetin e tij tregtar “*bar-pastiçeri*”, të cilin e ushtron nga viti 2015, ndërsa pjesa tjetër është ruajtur prej tij si kursime të familjes së tij në shtëpi”. QKB-ja⁶⁵ informon se shtetasi A.C figuron i regjistruar si person fizik me NIPT ***, regjistruar në datën 31.7.2015, me objekt të aktivitetit “*bar-pastiçeri*”.

11.2.1 Rezulton se, edhe pse transfertat ka mbërritur në llogarinë e babait të subjektit gjatë kohës kur subjekti jetonte me prindërit e saj, konstatohet se ajo nuk ka përfutur nga kjo vlerë, pasi vlera 40.000 euro është mbajtur si depozitë deri në shtator 2012, në kohën kur subjekti kishte lidhur martesë dhe jetonte me shtetasin B.H.

11.3 Komisioni hartoi analizën financiare për mundësinë e vëllait për të kursyer vlerat e transferuara në vitet 2007 dhe 2010 me vlerë totale 72.966 euro, me burim të ardhurat nga emigracioni:

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Akumulative për periudhën 2005 – 2011
Të ardhurat e vëllait (A.C) nga emigracioni	8,829 euro	19,469 euro	24,445 euro	22,786 euro	22,864 euro	21,452 euro	5,178 euro	155,039 euro
Shpenzimet jetike sipas Eurostat-it	6,581 euro	7,790 euro	7,427 euro	4,744 euro	12,146 euro	7,263 euro	2,023 euro	91,773 euro
Rezultati financiar	2,248euro	11,679 euro	17,018 euro	18,042 euro	10,718 euro	14,189 euro	3,155 euro	77,049 euro

11.3.1 Sa rezulton për shtetasin A.C, rezultati financiar i periudhës 2005 – 2011 është në total 77.049 euro. Pra, ai ka pasur mundësi të kursejë dhe më pas të transferojë vlerën e tyre, prindërve të tij me vlerë totale transfertash 72.966 euro (22.965 euro në vitin

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2021, e QKB-së, protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 18.3.2021.

2007 dhe 50.000 euro në vitin 2010).

Vlera e transferuar në vitin 2007 deklarohet se është përdorur për blerjen e automjetit të shtetasit A.C, ndërsa vlera e transferuar në vitin 2010 është mbajtur si depozitë deri në vitin 2012, pasi subjekti kishte lidhur martesë me shtetasin B.H dhe është përdorur për aktivitetin ekonomik të vëllait të saj.

11.3.2 Trupi gjykues, në përfundim të hetimit, çmon se subjekti nuk ka përfituar nga këto transferta dhe nuk ka kontribuar në krijimin e tyre.

12. Gjatë hetimit, e pyetur mbi adresat e banimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, se për periudhën 1.8.2018 – 31.7.2019 vendbanimi i saj ka qenë rruga “****”, hyrja ****, ap. ****, Njësia Bashkiake Nr. **** Tiranë, apartament i marrë me qira nga shtetasi A.N kundrejt vlerës 24.000 lekë/muaj sipas kontratës noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë 27.7.2018. Pagesat janë bërë mujore nëpërmjet bankës në llogarinë e bashkëshortes së z. A.N. Bashkëlidhur me pyetësorin standard, subjekti përcjell kopje të kontratës nr. **** rep., nr. **** kol., datë 27.7.2018, në të cilën përcaktohet afati njëvjeçar 1.8.2018 – 31.7.2019 dhe mandatet bankare të pagesave të kryera në “Raiffeisen Bank”. “Raiffeisen Bank”⁶⁶ informon se pagesat janë kryer me transfertë bankare nga llogaria rrjedhëse e z. B.H drejt llogarisë së shtetases A.L. N., me vlerë 24.075 lekë/muaj prej gushtit 2018 deri në qershor të vitit 2019.

12.1 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁶⁷ dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁶⁸, nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit janë gjykuar çështje me palë shtetasit A.N dhe A.L.N. Në kthim përgjigje, gjykatat bëjnë me dije se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë shqyrtuar çështje gjyqësore me palë shtetasit e lartpërmendur.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

13. Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajshme, të paluajshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

14. Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat në vlerë neto, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁶⁹, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, këto vlera janë krahasuar edhe me transfertat⁷⁰ e realizuara në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortit për të ardhurat nga pagat e tyre.

⁶⁶ Shkresë nr. **** prot., datë 12.3.2021, nga “Raiffeisen Bank” sh. a.

⁶⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 16.2.2023, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresa kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 21.3.2023, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

⁶⁸ Shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 10.2.2023, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 9.3.2023, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

⁶⁹ Shkresa kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 2.3.2021, e ISSH-së, protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 3.3.2022; shkresë kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 3.3.2021, e DPT-së, protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 8.3.2021; vërtetimet e institucioneve të përcjella me deklaratën *Vetting* në aneksin nr. **** dhe aneksin nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁰ Shkresë nr. **** prot., datë 12.3.2021, e “Raiffeisen Bank” sha; shkresë nr. **** prot., datë 19.3.2021, e BKT-së sh.a.; shkresë nr. **** prot., datë 2.3.2021, e OTP Bank; shkresë nr. **** prot., datë 10.3.2021, e “ProCredit Bank”; shkresë nr. **** prot., datë 25.3.2021, e ISP Bank.

15. Të ardhurat nga bashkëshorti, të krijuara para martesë, përfshijnë vlerën e likuiditeteve dhe pasurive, të cilat rezultojnë në emër të bashkëshortit dhe provohet se janë krijuar para martesës me subjektin. Arsyeja e vendosjes së tyre në këtë zë është për të shmangur efektet artificiale dhe të palidhura me subjektin që mund të krijohen nga përfshirja e pasurive të tilla të bashkëshortit në analizën financiare të Komisionit.

16. Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, drejtuar Komisionit. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare është përfshirë numri i anëtarëve të familjes për të cilët është bërë trajtimi i shpenzimeve jetike në bazë të deklaratimit të subjektit në pyetësin standard, por duke u mbështetur edhe në gjendjen familjare sipas certifikatave të gjendjes civile.

Pra, prej vitit 2003 deri në nëntor të vitit 2011 në analizë janë përfshirë prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe subjekti i rivlerësimit. Pas martesës me shtetasin B.H, në nëntor 2011 – janar 2012 janë llogaritur për familje me dy anëtarë dhe pas lindjes së vajzës së tyre (janar 2012) e në vijim deri në dhjetor 2016 shpenzimet jetike janë llogaritur si familje me tre anëtarë.

17. Shpenzimet për efekt të llogaritjes në analizën financiare, pas shkëputjes nga familja prindërore me martesë ligjore, përfshijnë vlerën e pasurive dhe likuiditeteve, të cilat ishin në pronësi të prindërve të subjektit dhe, si pasojë, edhe të përfshira në analizën financiare të saj, deri në nëntor 2011 kur është shkëputur prej tyre me martesë. Arsyeja e përfshirjes së tyre në analizë është për të shmangur efektet artificiale dhe të palidhura me analizën financiare të subjektit që mund të krijohen nga heqja e pasurive të tilla të prindërve në analizën financiare të Komisionit.

18. Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, si dhe në deklaratimet e subjektit⁷¹. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Në rastet e tjera, kur deklaratimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit.

19. Shpenzimet për blerje automjesh⁷² u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, pyetësorët, si dhe në dokumentacionin përkatës.

20. Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë vjetorë.

21. Gjendja e likuiditeteve⁷³ në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

21.1 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikua dhe u krahasua përputhshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë vjetorë, në deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Sa më sipër, rezultati i analizës financiare për periudhën 2003 – 2016 është me vlerë pozitive.

⁷¹ Përgjigjet e pyetësorit standard.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.11.2022.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2021, “Raiffeisen Bank” sh.a.; shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2021, e BKT-së sh.a.; shkresë nr. *** prot., datë 2.3.2021, e OTP Bank; shkresa nr. *** prot., datë 10.3.2021, e “ProCredit Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021, e ISP Bank.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	0	50	813	910,163	(834,479)	57,031	5,698,418	1,759,932	759,458	(42,117)	2,167,774	511,999	817,667
Shtëpi banimi 3 kate, sipërfaqja 190 m2, pjesa takuese 25%, Lagjia nr.*, Rr. "B.L*", K*, Burimi i krijimit: Me të ardhurat e përbashkëta të familjes dhe të ardhurat nga emigracioni i vëllait.														
Autoveturë Renault Clio Targa KJ*, Vlera 200 000 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi: Kontratë shitblerje nr. *, dt. 31.07.2003, me të ardhura nga paga.												(75,000)		
Apartament banimi me sip. 85.74 m2, Rr. D* B*, T*. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga. Vlera 2 257 200 lekë. Pjesa takuese e bashkëshortit 100%									2,257,200					
Garazh me sip.18.76 m2, Rr. D* B*, T*. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga Vlera 393 960 lekë. Pjesa takuese e bashkëshortit 100%									393,960					
Autoveturë Renault Megane me targë A*, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit sipas deklaratës noteriale nr.* Rep., Nr.* Kol datë 14.10.2016 lëshuar nga pronari A* C*.														
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	0	0	50	813	910,163	-834,479	57,031	5,698,418	-891,228	759,458	-42,117	2,242,774	511,999	817,667
Gjendje kursimesh cash										1,676,640	1,682,520		500,000	
Total likuiditete	0	0	50	863	911,026	76,547	133,578	5,831,996	4,940,768	5,700,226	5,658,109	7,900,883	8,412,882	9,230,549
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	0	0	50	813	910,163	(834,479)	57,031	5,698,418	1,759,932	759,458	(42,117)	2,167,774	511,999	817,667
TË ARDHURA të dokumentuara	828,143	1,041,364	1,042,519	1,086,317	1,947,267	1,266,933	1,151,199	6,759,858	8,719,249	1,876,370	1,294,694	3,380,980	2,155,408	3,247,695
Të ardhura neto nga bursa e studimeve si kandidatë për magjistrate në Shkollën e Magjistraturës për periudhën 1999-2001. Vlera 488 780 lekë														
Të ardhura nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për periudhën tetor 2001-tetor 2002. Vlera 502 524 lekë														
Të ardhura nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nga muaji nëntor 2002 deri nëntor 2013.	603,239	816,460	817,615	861,413	804,071	847,629	926,295	889,946	829,587	10,000	862,210			
Të ardhura nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë, nga muaji nëntor 2013 deri dhjetor 2016.											72,860	1,114,290	1,136,494	1,167,463
Të ardhurat të subjektit nga pjesëmarrja si eksperte në Shkollën e Magjistraturës					24,020	194,400			10,800					
Të ardhurat nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit	224,904	224,904	224,904	224,904	224,904	224,904	224,904	224,904	206,162					
Të ardhurat nga pensioni i nënës të subjektit të rivlerësimit									92,608	127,336				
Të ardhura nga paga, shërbime si inxhinier në shoqërinë D*-C* I* GMBH për periudhën gershor 2003 prill 2008. Shuma 45 700 USD dhe 16 500 Euro.														
Të ardhura nga paga, shpërblime si inxhinier në shoqërinë D*-A* sh.p.k. për periudhën maj 2008 – gusht 2012, shuma 69 828 euro dhe 1 115 264 lekë.									207,450	1,115,264				
Të ardhura nga paga, dieta si inxhinier, Ekspert teknik pranë Nj* së K* të p* (PCU) për periudhën Prill 2012-Shkurt 2013. Vlera 955 544 lekë.										71,679	96,068			
Të ardhura nga paga shpërblime si inxhinier në shoqërinë A* sh.p.k për periudhën shkurt 2013-janar 2014. Shuma 312 519 lekë.											234,519	28,840		
Të ardhura nga paga, shpërblime si Inxhinier në shoqërinë M* M* shpk për periudhën shkurt 2014 – tetor 2014. Shuma 2 371 322 lekë												2,189,734		
Të ardhura nga paga, shpërblime si Inxhinier në Shoqërinë T* N* S* sh.p.k për periudhën nëntor 2014- shtator 2015. Shuma 288 690 lekë.													175,006	
Të ardhura nga paga, shpërblime si inxhinier në shoqërinë I* sh.p.k për periudhën nëntor 2015-shkurt 2016. Shuma 450 000 lekë												45,270	90,540	
Të ardhura nga paga shpërblime si inxhinier në shoqërinë E* C* sh.p.k për periudhën gusht 2015- dhjetor 2016. Shuma 3 120 156 lekë.													753,368	2,080,104
Të ardhurat e bashkëshortit nga interesat e depozitave									10,779	42,581	29,037	2,846		128
Të ardhura të subjektit nga leja e lindjes									65,887	636,846				
Për efektë analizës financiare janë gjendjet e llogarive bankare të babait të subjektit të cilat janë transferuar nga vëllai i saj					894,272			5,552,400						
Të ardhurat nga bashkëshorti të krijuara para martesë									7,261,248					
SHPENZIME	353,892	353,892	400,671	400,671	481,860	481,860	481,860	481,860	6,130,600	503,015	479,072	914,046	734,771	960,695
Shpenzime për efekt të llogaritjes në analizën financiare pas shkëputjes nga familja prindërore me martesë ligjore									5,552,400					
Shpenzime udhëtimi në funksion të punës (K*-F*), pyetësor nr. 2	72,000	72,000	72,000	72,000	72,000	72,000	72,000	72,000	76,000	96,000	56,000			
Shpenzime udhëtimi									103,725	-	-	254,052	61,943	255,419
Shpenzime jetese	281,892	281,892	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	398,475	407,015	423,072	659,994	672,828	705,276
Analiza dokumentuar	474,251	687,472	641,798	684,833	555,244	1,619,552	612,308	579,580	828,716	613,897	857,739	299,160	908,638	1,469,333

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (sot Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 10.1.2023, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Si konkluzion, Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Nafije Hasko.

3. Komisioni ka kërkuar nga DSIK-ja përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nafije Hasko.

4. Në përgjigje, me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2022, Komisioni u informua se: “*...disponohen të dhëna të vitit 2017 – 2018 ...por nuk është qartësuar/dokumentuar shkalla e përfshirjes së mundshme në paligjshmëri. Të dhënat nuk kanë pasur vijueshmëri dhe nuk janë vërtetuar*”.

5. DSIK-ja (sot AKSIK) informoi⁷⁴ se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin, përveç atyre si më lart dhe, për pasojë, nuk ka një ndryshim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Hetimi i Komisionit

6. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, të cilat janë trajtuar në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit.

6.1 Nga verifikimet e kryera nuk rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

6.2 Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin indicie për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas

⁷⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 14.12.2022 dhe nr. *** prot., datë 20.12.2022.

parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Në zbatim të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. *** prot., datë 13.04.2021, si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësi profesionale; (b) aftësi organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësi personale dhe angazhimit profesional.

1.1 Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit⁷⁵, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor⁷⁶; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Hetimi i Komisionit

2. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu hetim të pavarur në lidhje me 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me 5 dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv.

2.1 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, kualifikon drejt marrëdhënien juridike objekt shqyrtimi gjyqësor, njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit. Vendimet gjyqësore të arsyetuara nga subjekti janë të qarta dhe të kuptueshme. Gjatë periudhës së rivlerësimit (8.10.2013 – 8.10.2016), subjekti ka përfunduar 2122 çështje gjyqësore, nga 2303 çështje dhe rendimenti i përfundimit të çështjeve është 92.1%⁷⁷. Lidhur me afatin standard të gjykimit të përcaktuar në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve⁷⁸, në katër raste afati standard i gjykimit prej 1 muaji është tejkaluar, megjithatë nuk vërehen shkaqe që të kenë cenuar standardin kushtetues të një gjykimi “brenda një afati kohor të arsyeshëm”. Në

⁷⁵ Dokumenti 1: vendimi gjyqësor nr. ***, datë 13.3.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse M.SH dhe të paditur Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DAP, me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. ***, datë 25.11.2013, si dhe nr.**, datë 26.11.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm ...”; dokumenti 2: vendimi gjyqësor nr. ***, datë 21.11.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me paditës shoqëria “****” sh.p.k., i paditur Ministria e Financave, AAPSK, me objekt “Shpërbllim dëmi jashtëkontraktor”; dokumenti 3: vendimi gjyqësor nr. *** (***) datë 20.1.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me paditës “****” sh.a. dhe të paditur DRTT, me objekt “Anulimin e aktit administrativ “Urdhër Sekuestrimi”...”.

⁷⁶ Dosja 1: çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 18.6.2014, me paditës M.DH, të paditur ALUIZNI, me objekt “Konstatim i paligjshmërisë së urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNIT nr.***, datë 10.12.2013...”; dosja nr. 2: çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 11.5.2015, me paditës “****” sh. a., të paditur NJMLF, Komisioni i Apelit të Gjobave, MF, me objekt: “Shfuqizim akti administrativ, procesverbal gjobe...”; dosja nr. 3: çështja gjyqësore nr.*** regj., dt. 31.12.2013, me paditës E.B, të paditur “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me objekt: “Shfuqizim i urdhrit... Për lirim nga policia e shtetit”; dosja nr. 4: çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 9.8.2016, me paditës Y.A, të paditur Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 8.8.2016 ...”; dosja nr. 5: çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 15.1.2014, me paditës V.G, të paditur MBZHRAU, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me pagën e një viti pune për zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës ...”.

⁷⁷ Në interpretim të pikës 3, shkronja “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për 3 vjet. Nga të dhënat statistikore të gjyqtarës Nafije Hasko, konstatohet lehtësisht se ajo ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë që përbën trefishin e standardit minimal.

⁷⁸ Miratuar nga ish-KLD-ja me vendimin nr. ***, datë 14.4.2010.

efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së saj ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore tepër e lartë me çështje të gjykuara. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi të mira në kryerjen e procedurave gjyqësore dhe në administrimin e dosjeve gjyqësore. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës. Nga administrimi i burimeve për kryerjen e rivlerësimit konstatohet se subjekti i rivlerësimit ruan paanësinë në gjykim dhe respekton barazinë e palëve. Bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët ka qenë në nivelin e duhur. Subjekti ka ndjekur programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

2.2 Nga dosjet e analizuara u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime vetëm për dosjen nr. 5 të shortuar, që i përket çështjes gjyqësore nr.*** regj., datë 15.1.2014.

Lidhur me këtë çështje, në përfundim, subjekti ka disponuar me pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 5.3.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit, procesverbali gjyqësor në shkallën e parë nuk është nënshkruar në çdo faqe të tij nga sekretarja gjyqësore, fakt që përbën shkelje të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

2.3 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë mangësi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3. Subjekti depozitoi në Komision propozime, ku parashtrroi fillimisht se sipas nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile, procesverbali i seancës gjyqësore mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore dhe se sipas kësaj dispozite, nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim. Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit, nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës dhe përfshihet në dosjen gjyqësore.

3.1 Në vijim, ajo shpjegoi se pikërisht në kohën e këtij gjykimi (janar 2014) filloi efektivisht funksionimi i gjykatave administrative dhe puna e gjyqtarëve hasi në disa problematika, që kishin të bënin me: (a) mungesën e infrastrukturës (sallat e gjykimit nuk kanë pasur të instaluar sistemet e regjistrimit audio të seancave gjyqësore, numri i pamjaftueshëm i sallave të gjykimit bënte që gjykimet të zhvilloheshin në zyrat e gjyqtarëve, ku mungonin mjetet e infrastrukturës; (b) sekretare gjyqësore të patrajnuara dhe të pakualifikuara për pozicionin e vendit të punës, me një mbingarkesë aspak normale të punës. Në këto kushte, procesverbali gjyqësor për gjykimet e zhvilluara për vitin 2014 është mbajtur në formë të përmbledhur me shtypshkrim, si edhe në rastin konkret, për të cilin ka rezultuar se sekretarja gjyqësore ka nënshkruar vetëm në fund procesverbalin gjyqësor, por jo në çdo faqe të tij. Në vijim, subjekti shpjegoi se: *“Detyrimi i sekretarës gjyqësore për nënshkrimin në çdo faqe të procesverbalit dhe jo vetëm në fund të tij u sanksionua me ndryshimet e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 122/2013, ndryshime që kishin pak kohë që kishin hyrë në fuqi dhe siç e theksova dhe më sipër, sekretaret gjyqësore nuk ishin të kualifikuara apo të trajnuara për pozicionin e tyre të punës. Tre sekretaret gjyqësore, me të cilat kam punuar në këtë periudhë (edhe në këtë gjykim), janë larguar nga detyra njëra pas tjetrës në muajt mars dhe prill*

2014, për shkak të shkeljeve të rënda në përmbushjen e detyrës ... , fakte këto që kanë vështirësuar së tepërmi punën⁷⁹”.

3.2 Në vijim, subjekti parashtroi se ajo i ka përmbushur në përputhje me ligjin detyrimet e saj procedurale, pasi ajo ka nënshkruar në fund të procesverbalit gjyqësor dhe mungesa e nënshkrimit në çdo faqe të procesverbalit është e lidhur me detyrën funksionale të sekretares gjyqësore dhe është përgjegjësi individuale e saj.

3.3 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

4. Në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe atyre të dhëna në seancë dëgjimore në datën 27.4.2023, trupi gjykues vlerësoi se mangësia në fjalë nuk lidhet me veprimtarinë e gjyqtares, por të sekretares gjyqësore. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE TË KLGJ-SË

5. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Nafije Hasko, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish- Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

6. Nga baza e të dhënave të ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Nafije Hasko janë paraqitur gjithsej 11 ankesa⁸⁰ në Inspektoratin e ish-KLD-së.

6.1 Gjashtë ankesa (3 të vitit 2013, 2 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat, 1 prej tyre me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 4 prej tyre si ankesa të përsëritura, 1 ankesë është arkivuar me arsyetimin se nuk përmban fakte dhe rrethana të vlefshme për verifikim dhe pretendimet dalin tej kompetencave të Inspektoratit.

6.2 Pesë ankesa (1 e vitit 2014, 3 të vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijojnë:

- Për dy prej tri ankesave të vitit 2015, verifikuar për zvarritje, është vendosur evidentim për efekt vlerësimi etik e profesional gjyqtares, ndërsa për tjetrën është vendosur propozimi i kryerjes së inspektimit të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtares Nafije Hasko.
- Për një ankesë të vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është vendosur mbajtja e verifikimit në vijim deri në kthimin e gjyqtares nga leja e lindjes. Më pas, me krijimin e ILD-së, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni⁸¹.
- Një informacion nga gjykata i vitit 2014 është bashkuar me një informacionin tjetër të vitit 2015 dhe janë trajtuar së bashku. Në përfundim të verifikimit është konkluduar propozimi i kryerjes së inspektimit të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtares Nafije Hasko, sikurse është cituar edhe më lart.

⁷⁹ Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti depozitoi urdhrat e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për lirimin nga detyra të sekretareve gjyqësore, konkretisht urdhrat nr. ***, datë 5.3.2014; nr. ***, datë 1.4.2014; nr. ***, datë 9.4.2014 dhe nr. ***, datë 13.11.2014.

⁸⁰ 3 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 4 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016.

⁸¹ Me procesverbalin nr. *** prot., datë 28.7.2015.

7. Nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë u informua⁸² se pranë këtij institucioni, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, janë paraqitur 9 ankesa, si në vijim:

7.1 Ankesa e O.S.P.N ***, depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 29.3.2019, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 14.7.2020.

Me vendimin nr. *** prot., datë 22.12.2020, është vendosur arkivimi i ankesave të bashkuara të ankuesit OSPN, Sekretarit të Përgjithshëm të saj, z. G.T, dhe me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2020, janë njoftuar subjektet e interesuara në lidhje me këtë vendim.

7.2 Ankesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 26.11.2015, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 28.1.2021.

ILD-ja, në përgjigjen e dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2016, sqaruar se: *“Nga verifikimi i kryer konstatohet se nga 11 vendimet gjyqësore që kanë dhënë subjekte të ndryshme rivlerësimi, gjyqtare Nafije Hasko ka dhënë vendimin nr. ***, datë 10.8.2015, dhe në kohën e kryerjes së verifikimit nuk ishte përfunduar gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit. Nisur nga fakti se kategoria e shkeljes së pretenduar në këto vendime është e njëjtë, çmohet që përpara se të jepen përgjigje për ato pretendime të pritët përfundimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë i shqyrtimit edhe për dhjetë vendimet e tjera, me qëllim daljen me një konkluzion të përbashkët për ankesën”*.

Komisioni shqyrtoi në mënyrë të pavarur çështjen objekt ankese dhe në përfundim nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale.

7.3 Ankesa e shtetasës SH.D, depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 14.1.2019, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 1.6.2020. Shtetasja SH.D ka pretenduar se nga gjyqtare Nafije Hasko dhe disa subjekte të tjera është mbyllur çështja e saj për pension, nuk e kanë njoftuar për seancat gjyqësore dhe nuk kanë arsyetuar vendimin.

Nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, bashkëlidhur ankimit, rezulton se kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 7.4.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin ishte vendosur pushimi i çështjes. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit rezulton se në seancën përgatitore të datës 7.4.2016 pala paditëse, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, ka deklaruar se në bazë të nenit 201/1 të Kodit të Procedurës Civile hiqte dorë nga gjykimi i çështjes, duke kërkuar pushimin e gjykimit të kësaj kërkesëpadie, për shkak se nuk e çmonte të nevojshëm vazhdimin e gjykimit.

Në përfundim, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale.

7.4 Ankesa e shtetasit A.Ç depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 25.4.2019, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 10.6.2020. Në ankesë ai ka pretenduar se ka pasur zvarritje të procesit dhe njëanshmëri. Sipas informacionit të përcjellë me shkresën nr.*** prot., datë 11.6.2020, të ILD-së, ankesa është ende në shqyrtim.

Në përfundim, trupi gjykues çmoi se kjo ankesë është jashtë periudhës së rivlerësimit dhe

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021, e ILD-së.

është objekt shqyrtimi i organeve të reja të drejtësisë.

7.5 Ankesa e shtetasit A.H, depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 1.4.2016, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 14.7.2020. Shtetasi A.H⁸³ ka ngritur pretendime se gjyqtarja Nafije Hasko e ka shpallur të paarsyetuar vendimin nr. ***, datë 16.3.2016, në kundërshtim me ligjin dhe se i ka cenuar të drejtën e ankimit.

Ndaj vendimit në fjalë, ku subjekti ka vlerësuar se kërkesëpadia është e pambështetur në prova e ligj, është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 7.11.2017, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

ILD-ja ka sqaruar⁸⁴ shtetasin A.H se gjyqtarja Nafije Hasko, nga data 1.6.2017, është me raport leje lindjeje dhe, për pasojë, nuk mund të merret deklaram lidhur me ankesën dhe se në pamundësi për të bërë të mundur përfundimin e detyrave të verifikimit në këtë gjykatë, çmohet të lihet në vijim verifikimi i çështjes deri në kthimin e saj në detyrë. Ndërsa për elementin tjetër të ankuesit se gjyqtarja Nafije Hasko e ka cenuar nga e drejta e ankimit për shqyrtimin e çështjes në shkallë të dytë, rezulton se kundër vendimit nr. ***, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shtetasi A.H ka depozituar ankim në datën 30.3.2016 brenda afatit ligjor 15-ditor.

Në përfundim, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale.

7.6 Ankesa e shtetasit G.D, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 23.10.2020. ILD-ja ka vendosur arkivimin e kësaj ankesë⁸⁵.

Në përfundim, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale.

7.7 Ankesa e subjektit “**”,** regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 25.6.2020. Ankesa ka të bëjë me një çështje në proces shqyrtimi nga subjekti i rivlerësimit.

Trupi gjykues nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale, pasi në bazë të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

7.8 Ankesa e shtetasit R.B, depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 30.9.2020. Shtetasi R.B ka depozituar edhe në Komision denoncimin nr. ***, datë 30.9.2020, i cili është trajtuar në poshtë, në seksionin e denoncimeve nga publiku.

7.9 Ankesa e shtetasit P.B, depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 16.12.2016, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 14.7.2020. Shtetasi P.B ka depozituar edhe në Komision denoncimin nr. ***, datë 16.12.2019, i cili është trajtuar më poshtë, në seksionin e denoncimeve nga publiku.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

⁸³ Në çështjen administrative të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit objekt ankesë në ILD, shoqëria “****”, përfaqësohet me prokurorë të posaçme nga punonjësi i autorizuar A.H.

⁸⁴ Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.5.2018.

⁸⁵ Bashkëlidhur ankesës është përcjellë shkresa nr. *** prot., datë 30.12.2020, “Vendim për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z. G.D”.

8. Në përfundim, pas verifikimit dhe analizimit në mënyrë të pavarur të tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura me short, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së dhe ILD-së, trupi gjykues vlerësoi se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

9. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar pranë Komisionit 12 denoncime. Pasi shqyrtoi secilin prej tyre, trupi gjykues administroi dosjet, shqyrtoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime.

9.1 Denoncim nr. *** prot., datë 20.6.2019, i shtetasit N.M

9.1.1 Denoncuesi pretendon se nga disa subjekte të rivlerësimit, duke përfshirë edhe subjektin Nafije Hasko, në dhënien e vendimit nr. ***, datë 15.11.2016, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, *nuk është disponuar drejt, janë shtrembëruar dhe tjetërsuar faktet*. Denoncuesi pretendon për mosshqyrtim të akteve e provave, ku ka parashtruar pretendimin e falsifikimit të tyre. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit kopje të vendimit nr. ***, datë 15.11.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe kopje të vendimit nr. *** (***), datë 31.10.2017, dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

9.1.2 Rezulton⁸⁶ se shtetasi N.M i është drejtuar gjykatës me kërkesën, me objekt “Sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 10.10.2014⁸⁷”, dhënë nga Bashkia Tiranë në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. për ndërtimin e një kompleksi pallatesh, ku person i tretë ka qenë Bashkia Tiranë, shoqëria “****” sh.p.k.

9.1.3 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë për pezullimin e lejes së ndërtimit nr. ***, datë 10.10.2014, të dhënë nga Bashkia Tiranë në favor të shoqërisë së ndërtimit “****”*.

Ndaj vendimit është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.11.2016.

9.1.4 Komisioni hetoi nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit kishte vendimmarrje themeli për çështjen e lartpërmendur dhe nga aktet e vendosura në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁸⁸ rezultoi se çështja është regjistruar në datën 25.11.2016 dhe nga subjekti është shqyrtuar deri në datën 31.5.2017, pasi në datën 12.6.2017 çështja është rishortuar dhe i ka kaluar për shqyrtim një tjetër subjekti rivlerësimi,⁸⁹ pasi gjyqtarja Nafije Hasko është larguar me leje lindjeje.

⁸⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2023.

⁸⁷ Shoqërisë “****” sh.p.k., në bazë të vendimit nr. ***, datë 10.10.2014, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, i është miratuar leja në favor të zhvilluesit, shoqërisë “****” sh.p.k., për ndërtimin e një kompleksi banimi në pronësi të shtetasit K.F etj., me vendndodhje në Y, për sipërfaqe ndërtimi 24000 m², me afat kohor deri në datën 10.10.2020. Kërkuesi N.M është i pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 9.2.2016, nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana ***, për objektin godinë banimi 1 kat, me adresë Njësia Bashkiake nr. ***, z. k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 300.2 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 63.7 m².

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2023, dhënie informacioni, e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

⁸⁹ Çështja administrative është gjykuar në vijim nga gjyqtarja E.SH, e cila, me vendimin nr. ***, datë 11.12.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ndaj vendimit është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ku deri në datën e mbërritjes së shkresës çështja nuk ishte gjykuar ende.

9.1.5 Komisioni mbajti parasysh faktin se bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Vlerësimi i Komisionit

9.1.6 Trupi gjykues vlerësoi se pretendimet, objekt i këtij denoncimi, nuk shtrihen mbi shkelje në lidhje me drejtimin e gjykimit apo mohimin e të drejtave të palëve në proces, por me vlerësime të gjyqtarit që lidhen me analizën ligjore dhe çmuarjen e provave sipas bindjes së brendshme dhe në bazë të pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi nuk mund të shtrihet ndaj interpretimit apo logjikës së gjyqtarit në gjykimin e çështjes.

Trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit. Në përfundim, vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.2 Denoncim nr. * prot., datë 18.8.2021, i shtetasit Q.M**

9.2.1 Shtetasi Q.M pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim në kundërshtim me ligjin në çështjen administrative me palë: paditës Q.M, të paditur familjarë të tjerë të familjes M. dhe Komisioni i Ndarjes së Tokës, Bashkia M, me objekt “Pavlefshmëria absolute e AMTP-së nr. ***, viti 1995, në emër të shtetasit A.M”. Gjithashtu, pretendon se nuk është njohur me vendimin e gjykatës, pasi në datën e shpalljes së tij nuk ka qenë prezent për shkak se ka qenë në spital⁹⁰ dhe se prezent nuk ka qenë as avokati i tij dhe si pasojë e mosnjohjes me vendimin dhe në pamundësi të komunikimit me avokatin ka humbur afatin 15-ditor të ankimit ndaj këtij vendimi.

9.2.2 Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se:

- Subjekti i rivlerësimit, pasi ka analizuar në tërësi çështjen, aktet shkresore të paraqitura me cilësinë e provës nga palët ndërgjyqëse dhe të administruara gjatë gjykimit, ka çmuar se kërkesëpadia duhet rrëzuar.

Gjatë analizimit të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur në konsideratë kuadrin ligjor të ligjit për tokën dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij⁹¹.

Sa i përket pretendimit për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, AMTP-së objekt gjykimi për shkak se ka dalë në shkelje të rëndësishme të procedurës dhe të formës së nxjerrjes së tij, gjykata ka arsyetuar se shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, por jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpien detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit. Mosrespektimi i formës dhe procedurës të referuara në shkronjën “c” të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të jetë i atij karakteri dhe asaj rëndësie që të ketë ndikuar drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktit administrativ.

9.2.3 Në lidhje me zgjidhjen në themel të kësaj çështjeje, Komisioni mbajti në konsideratë pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

⁹⁰ Bashkëlidhur denoncimit, librezat e përfituesit të statusit të invalidit paraplegjik-tetraplegjik.

⁹¹ Legjislacioni për trajtimin me tokë bujqësore; kriteret e përcaktuara nga nenet 3 e 4 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”; VKM-ja Nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”; vendimi nr. 230, datë 22.7.1991, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e komisioneve të tokave”; i ndryshuar; VKM-ja Nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”; VKM-ja Nr. 161, datë 8.4.1993, “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”; Udhëzimi Nr. 2, datë 2.8.1991, i Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra”.

Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”. Bazuar në këtë dispozitë, vlerësimi i zgjidhjes së çështjes në themel nga ana e subjektit nuk është kompetencë e Komisionit.

9.2.4 Në lidhje me pretendimin e paditësit se ka humbur afatin e ankimit pasi nuk i është njoftuar vendimi dhe nuk ka qenë i pranishëm në shpalljen e vendimit as ai dhe as avokati, Komisioni mbajti parasysh faktin që neni 444 i Kodit të Procedurës Civile, me ndryshimet që kanë qenë në fuqi deri në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje (pa ndryshimet e bëra në vitin 2017), parashikonte që afati i ankimit fillon nga dita e shpalljes së vendimit.

Nga vendimi rezulton që ka qenë në mungesë pala e paditur dhe personi i tretë, por nuk rezulton të ketë qenë në mungesë paditësi (denoncuesi). Gjykata nuk është shprehur se ky i fundit ka qenë në mungesë, por ka parashtruar kërkimin përfundimtar të palës paditëse (avokatit të saj) në këtë proces gjyqësor.

9.2.5 Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime nëse pala (denoncuesi) kishte qenë apo jo prezent në shpalljen e vendimit dhe nëse i ishte njoftuar apo jo vendimi i gjykatës në lidhje me këtë çështje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.2.6 Subjekti depozitoi në Komision prapësime, ku parashtrroi se paditësi dhe përfaqësuesi i tij nuk kanë qenë të pranishëm në shpalljen e vendimit përfundimtar në seancë gjyqësore, por sekretaria e gjykatës i ka njoftuar paditësit vendimin nëpërmjet dëftesës së komunikimit të datës 31.5.2016 dhe paditësi për faj të tij ka humbur afatin e ankimit ndaj vendimit në fjalë. Konkretisht, ka sqaruar:

i. “...në procesverbalin e seancës gjyqësore, të datës 16.5.2016, të regjistruar me regjistrim audio, është dokumentuar fakti se pala paditëse dhe përfaqësuesi i tij, av. G.H, kanë qenë të pranishëm, ndërsa për palët e paditura dhe personat e tretë të paparaqitur ka vijuar gjykimi në mungesë. Përfaqësuesi i palës paditëse ka parashtruar konkluzionet përfundimtare, ku përfundimisht prej tij është kërkuar pranimi i padisë sipas objektit. Me mbylljen e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 305 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi është shtyrë për t’u zhvilluar në datën 23.5.2016 për shpalljen e vendimit përfundimtar të arsyetuar, në pamundësi objektive për ta shpallur brenda seancës, në vlerësim të kompleksitetit të çështjes, sipas parashikimit të nenit 42, pika 2 e LGJA-së⁹².”

Në seancën gjyqësore të datës 23.5.2016, sipas procesverbalit përkatës, rezulton i dokumentuar fakti që nuk kanë qenë të pranishme asnjë nga palët ndërgjyqëse, pra as paditësi dhe as përfaqësuesi i tij. Gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar pa praninë e palëve ndërgjyqëse”.

ii. Në vijim, ka sqaruar se për shkak të mosprezencës së palës paditëse dhe përfaqësuesit të tij në shpalljen e vendimit, në dispozitivin e vendimit përfundimtar, pika 3, është disponuar se “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e marrjes dijeni për vendimin”, në sinkron me parashikimin e nenit 444 të Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e këtij gjykimi: “Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është

⁹² “Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë”.

gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit”.

iii. Në lidhje me komunikimin e këtij vendimi gjyqësor, subjekti ka shpjeguar se është në pamundësi për të vendosur në dispozicion dëftesën e komunikimit nga sekretaria gjyqësore, pasi *“nga interesimi në kryesekretarinë e gjykatës rezultoi se dosja e kësaj çështjeje i është bashkuar çështjes administrative të vendimuar me nr. s'ka, në datën 10.4.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila i përket kërkuetit Q.M, me objekt “Rivendosje në afat e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 23.5.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, dosje e cila aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë.*

*Me vendimin nr. ***, datë 10.4.2017, është vendosur rrëzimi i kërkesës si i pambështetur në ligj dhe në prova. Nga përmbajtja e këtij vendimi, citohet se: “Sekretaria e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka realizuar komunikimin e vendimit tek paditësi Q.M nëpërmjet dëftesës së komunikimit datë 31.5.2016. Pala kërkuete ka pretenduar se për shkak të gjendjes shëndetësore dhe mungesës së njoftimit për komunikimin e vendimit pranë avokatit G.H, ka humbur afatin për të kundërshtuar vendimin nr. ***, datë 23.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë... Gjykata çmon se pala paditëse është kontradiktore në kërkimet që paraqet, pasi kërkon rivendosje në afat të palës kërkuete duke iu referuar humbjes së të drejtës për të paraqitur ankim prej përfaqësuesit ligjor. Gjykata, para së gjithash, konkludon se afatet dhe kërkesat në një procedurë gjyqësore i referohen palës dhe jo përfaqësuesve ligjorë. Përfaqësuesit ligjorë përfaqësojnë interesat e palëve që përfaqësojnë dhe këto tagra përfundojnë në bazë të vullnetit të të përfaqësuarit. Gjykata çmon se kërkueti ka pasur të gjitha kushtet dhe mundësitë për të kundërshtuar gjyqësisht vendimin nr. ***, datë 8.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në afatet e përcaktuara nga ligji. Kërkueti pretendon se ka humbur të drejtën për të ankimuar vendimin nr. ***, datë 23.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, për shkak të gjendjes shëndetësore. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se në të vërtetë nuk ka qenë ky shkak i humbjes së afatit... Pala kërkuete rezulton të ketë autorizuar përfaqësuesin e saj ligjor, të cilit duhet t'i kishte bërë me dije komunikimin e vendimit, në mënyrë që të ushtrohej e drejta e ankimit. Arsyeja e parashtruar si shkak për rivendosje në afat nuk është objektive, por është parashtruar në mënyrë abuzive”. Përfundimisht, gjykata e çmon këtë kërkesë të pabazuar në ligj dhe në prova dhe, si e tillë, ajo duhet rrëzuar”.*

Në vijim, subjekti ka sqaruar se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 13.6.2018 dhe ndaj këtij vendimi pala kërkuete Q.M ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë; dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë dhe ende nuk ka një vendim nga kjo e fundit.

Vlerësimi i Komisionit

9.2.7 Trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit.

9.3 Denoncim nr. * prot., datë 30.9.2020, i shtetasit R.B**

9.3.1 Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit në rigjykimin e çështjes administrative ka vepruar në shkelje ligjore dhe ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke favorizuar palët e paditura në gjykim në dhënien e vendimit nr. ***, datë 10.2.2020. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit

kopje të akteve dhe vendimeve gjyqësore të çështjes objekt denoncimi⁹³.

9.3.2 Nga aktet rezulton se shtetasi R.B ka qenë palë paditëse në një proces gjyqësor të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim të të cilit subjekti i rivlerësimit, pasi ka analizuar në tërësi çështjen, aktet shkresore të paraqitura në cilësinë e provës nga palët ndërgjyqëse dhe të administruara gjatë gjykimit, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Vlerësimi i Komisionit

9.3.3 Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe aktet përkatëse, vlerësoi se denoncimi ka të bëjë me fakte që lidhen me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes së gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, pasi bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.4 Denoncim nr.* prot., datë 19.2.2018, i shtetasit A.B**

9.4.1 Denoncuesi në denoncimin e tij referon se ka 20 vjet në proces gjyqësor për një pronë të fituar me trashëgimi nga babai i tij dhe ku pala e paditur në këto procese gjatë gjithë kohës ka hapur procese gjyqësore. Bashkëlidhur denoncimit ai ka depozituar vendimin nr. ***, datë 15.7.2002, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtarë e trupës gjyqësore me 3 anëtarë, ku në cilësinë e relatorit të çështjes ka qenë një tjetër subjekt rivlerësimi.

9.4.2 Nga vendimi rezulton se shtetasi B.B dhe familjarë të familjes B. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë, me objekt “Anulim i pjesshëm i vendimit nr. ***, datë 4.10.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe detyrimin e të paditurve, si dhe të KKKPronave që të na njohin bashkëpronarë mbi sipërfaqen e tokës... Sigurimin e objektit të padisë duke ndaluar Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të bëjë transkriptimin e kësaj prone, ku palë ka qenë Komisioni i Kthimi dhe Kompensimit të Pronave dhe trashëgimtarët e shtetasit B. B”.

9.4.3 Në përfundim të gjykimit, gjykata me vendimin e sipërpërmendur ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetura në ligj e në prova”.

Vlerësimi i Komisionit

9.4.4 Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe aktet përkatëse, vlerësoi se denoncimi ka të bëjë me fakte që lidhen me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes së gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, pasi bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të

⁹³ Shihni aktet bashkëlidhur denoncimit nr. ***prot., datë 30.9.2020, depozituar në Komision.

cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.5 Denoncim nr. * prot., datë 16.12.2019, i shtetasit P.B**

9.5.1 Në denoncimin e tij shtetasi P.B⁹⁴ pretendon se janë shkelur të drejtat për një proces të rregullt ligjor dhe e drejta e pronës e familjes B nga sistemi gjyqësor dhe nga vendimet abuzive e të paligjshme të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në gjykatat shqiptare. Ndër emrat e listuar të gjyqtarëve denoncuesi përmend edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit aktet shkresore ku bazon pretendimet e tij.

9.5.2 Sipas përmbajtjes së vendimit rezulton se Komisioni Vendor i Verifikimit të Vlefshmërisë së Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Tiranë ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë padinë, me objekt “Shfuqizimin e disa AMTP-ve në emër të familjes bujqësore me përfaqësues z. F.H.B dhe kthimin në pronësi shtet të sipërfaqeve të tokës”.

9.5.3 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e padisë, duke analizuar kuadrin ligjor të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe ndryshimet e tij.

9.5.4 Ndaj vendimit sa më sipër është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila, me vendim nr. ***, datë 28.10.2019, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 25.4.2017, dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit

9.5.5 Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe aktet përkatëse, vlerësoi se denoncimi ka të bëjë me fakte që lidhen me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes së gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, pasi bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.6 Denoncim nr. * prot., datë 12.6.2018, i shtetasit GJ.D**

9.6.1 Në denoncimin e tij, shtetasi GJ.D pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie, korrupsion, ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe ka pranim shkëmbim dhuratash nga persona të përfshirë në krimin e organizuar. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit kopje të vendimit nr. ***, datë 8.6.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka prishur vendimin nr. ***, datë 2.4.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

9.6.2 Nga përmbajtja e vendimit rezulton se paditësi/denoncuesi GJ.D ka qenë palë paditëse në një proces gjyqësor me palë të paditur Gardën e Republikës së Shqipërisë, për shkak të lirit të tij nga detyra dhe nxjerrjes në rezervë nga pala e paditur.

⁹⁴ Shtetasi P.B është trashëgimtar ligjor i të ndjerit F.B.

Çështja është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili në përfundim ka vendosur mospranimin e padisë, pasi nuk plotëson kushtet formale të saj. Ndaj vendimit sa më sipër ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë shtetasi G.J.D dhe kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 2.4.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes në po atë gjykatë për të vazhduar gjykimin me të njëjtin trup gjykues.

Gjykata Administrative e Apelit në arsyetimin e vendimit ka analizuar dispozitat e ligjit specifik që rregullon marrëdhëniet e punës së paditësit, duke arritur në përfundimin se marrëdhënia e punës mes palëve rregullohet sipas dispozitave *Lex specialis*, pra ligjit organik, konkretisht sipas dispozitave të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

Vlerësimi i Komisionit

9.6.3 Lidhur me pretendimin e denoncuesit për kontakte të papërshtatshme të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe për pranim/shkëmbim dhuratash nga subjekti me këta persona, denoncuesi nuk paraqiti të dhëna konkrete për të bazuar pretendimin e tij dhe, në këto kushte, këto pretendime mbeten në nivel deklarativ, të paprovuara. Komisioni shton se figura e subjektit është trajtuar në seksionin “Kontrolli i figurës” të këtij vendimi.

9.6.4 Lidhur pretendimet në denoncim mbi paligjshmërinë e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit si një vendimmarrje në kundërshtim me ligjin e posaçëm nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe me ligjin nr. 49/2012, datë 11.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Komisioni mbajti parasysh faktin se bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson. Denoncuesi e ka ezauruar të drejtën e tij ligjore për t’iu drejtuar një gjykatë më të lartë lidhur me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.7 Denoncim nr. * prot., datë 18.7.2018, i shtetasi SH.H**

9.7.1 Në denoncimin e tij shtetasi SH.H denoncon disa subjekte të rivlerësimit, një prej të cilëve është subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, duke pretenduar se këta subjekte/gjyqtarë kanë dhënë vendime të padrejta duke abuzuar me ligjin. Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar vendimet e gjykatave në të cilat denoncuesi mbështet pretendimet e tij, nga të cilët vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është ai me nr. ***, datë 22.2.2016.

9.7.2 Nga vendimi rezulton se subjekti ka gjykuar çështjen me palë paditëse Komisioni Vendor i Verifikimit të Ligjshmërisë së Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, me palë të paditur z. A.H dhe anëtarë të familjes bujqësore me mbiemrin H., me objekt “Shfuqizimin e disa AMTP-ve në emër të A.B.H, kthimin e sipërfaqeve në shtet dhe detyrimin e z. A.H për të paguar vlerën monetare të sipërfaqes së tokës së shitur”.

9.7.3 Pasi ka analizuar ndër të tjera dispozitat e ligjit nr. 9948, datë 7.7.2009, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, dhe aktet

nënligjore të dala në zbatim të rregullimit të dhënies se Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi⁹⁵, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Vlerësimi i Komisionit

9.7.4 Lidhur me pretendimet në denoncim mbi paligjshmërinë e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se pretendimet, objekt i këtij denoncimi, nuk kanë të bëjnë me shkelje në lidhje me drejtimin e gjykimit apo me mohimin e të drejtave të palëve në proces, por me vlerësime të gjyqtarit që lidhen me analizën ligjore dhe çmuarjen e provave sipas bindjes së brendshme. Bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.8 Denoncim nr. *** prot., datë 20.10.2021, i shtetases E.S

9.8.1 Denoncuesja nuk ka parashtruar pretendime lidhur me subjektin e rivlerësimit, por i ka bashkëlidhur denoncimit kërkesën datë 18.10.2021, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga çështja administrative nr. *** akti, regjistruar në datën 15.6.2021.

9.8.2 Nga informacioni i administruar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁹⁶, rezultoi se nga pala paditëse E.S janë paraqitur gjithsej 7 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko dhe asnjë nga kërkesat nuk është pranuar⁹⁷.

9.8.3 Denoncuesja nuk parashtroi pretendime konkrete për shkelje ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit, por vetëm kërkesat për përjashtimin e subjektit nga gjykimi, të cilat rezultoi se nuk janë pranuar nga gjykata.

⁹⁵ Trajtimin me tokë bujqësore sipas ligjeve të kohës, kriteret e përcaktuara nga VKM-ja Nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”; Vendimin Nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar, dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra”; VKM Nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”; VKM Nr. 161, datë 8.4.1993, “Për disa shtesa e ndryshime në VKM-në Nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore” dhe kriteret e përcaktuara nga nenet 3 e 4 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”; Udhëzimi nr. 5, datë 25.5.1993, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 8.4.1993”, përcakton në pikën 1 të tij se: “Përfitojnë tokë, pemë, frutore dhe rrënjë ullinjsh vetëm familjet e atëhershme qytetare e pronarë të tokës, sot me banim po në të njëjtin qytet, toka, pemët dhe ullinjët e të cilëve kanë shërbyer për themelimin e ish-kooperativave ose ndërmarrjeve bujqësore pranë qytetit, të formuar plotësisht ose në pjesën më të madhe me pronën e tyre”.

⁹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.11.2022).

⁹⁷ Në datën 1.6.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarit G.M, i cili me vendimin nr. ***, datë 10.6.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”. Në datën 2.6.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarit E.M, i cili me vendimin nr. ***, datë 21.6.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”. Në datën 21.6.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarit G.H, i cili me vendimin nr. ***, datë 23.6.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”. Në datën 15.6.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarit G.H, i cili me vendimin nr. ***, datë 23.6.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”. Në datën 15.7.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarit B.K, i cili me vendimin nr. ***, datë 23.6.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”. Në datën 15.7.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarit E.M, i cili me vendimin nr. ***, datë 23.6.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”. Në datën 20.10.2022, çështja me nr. ***, shqyrtuar pranë gjyqtarës E.V, e cila me vendim nr. ***, datë 18.11.2021, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Nafije Hasko nga gjykimi i çështjes”.

Vlerësimi i Komisionit

9.8.4 Për sa më lart, trupi gjykues çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.9 Denoncim nr. * prot., datë 16.3.2022, i av. A.M**

9.9.1 Denoncuesja rendit pakënaqësi lidhur me funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe thirrjen në gjykime të avokatëve kryesisht, sipas saj parë në këndvështrim të ushtrimit të profesionit si avokate. Denoncuesja referon edhe gjykimin e një çështjeje të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën pretendon se vendimi është i padrejtë, por pa referuar të dhëna të tjera.

9.9.2 Komisioni hetoi mbi vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit lidhur me shtetasen A.M, nga ku rezultoi⁹⁸ se subjekti ka shqyrtuar një çështje ku denoncuesja ka qenë përfaqësuese me prokurë e palës paditëse SH.K. Palë e paditur në këtë proces ka qenë Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe objekti i padisë ka qenë detyrimi i të paditurit të kryejë legalizimet për objektet e vetëdeklaruar nga paditësi.

9.9.3 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka analizuar në tërësi çështjen, legjislacionin që rregullon fushën konkrete, si dhe aktet shkresore të paraqitura me cilësinë e provës nga palët ndërgjyqëse dhe të administruara gjatë gjykimit, ka vendosur rrëzimin e padisë.

9.9.4 Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim nga paditësi në datën 12.4.2022 dhe deri në datën e kthim përgjigjes nuk ka vendim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Vlerësimi i Komisionit

Për sa më lart, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.10 Denoncim nr. * prot., datë 28.5.2019, denoncues H.R**

9.10.1 Denoncuesi H.R pretendon se nga ana e subjektit të rivlerësimit është shkelur dhe nuk është zbatuar ligji në dhënien e vendimit nr. ***, datë 26.3.2015.

9.10.2 Denoncuesi ka qenë palë paditëse në proces gjyqësor, me objekt “Pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e padisë”.

9.10.3 Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2015, ka vendosur: *“Lënie në fuqi të vendimit nr. ***, datë 26.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*.

Vlerësimi i Komisionit

9.10.4 Lidhur me pretendimet në denoncim mbi paligjshmërinë e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se pretendimet, objekt i këtij denoncimi, nuk shtrihen mbi shkelje në lidhje me drejtimin e gjykimit apo me mohimin e të drejtave të palëve në proces, por me vlerësime të gjyqtarit që lidhen me analizën ligjore dhe çmuarjen e provave sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit. Bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar

⁹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2022, “Dhënie informacioni dhe dërgim dokumentacioni”, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.11.2022).

korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9.11 Denoncim nr. * prot., datë 9.7.2020, me denoncues një grup juristësh të institucioneve (anonim - pa emra, pa nënshkrime)**

9.11.1 Denoncuesit kanë ngritur pretendime për disa subjekte rivlerësimi, që sipas tyre zhvillojnë gjykime jo të drejta e të paanshme, që i zhvillojnë gjykimet në kundërshtim me ligjin dhe marrin vendime abuzive e korruptive. Një ndër subjektet, objekt i këtij denoncimi, është znj. Nafije Hasko, për të cilën në denoncim është pretenduar se ka lidhje miqësore dhe familjare në *Vetting*. Gjithashtu, denoncuesi ka referuar dy çështje të gjykuara nga subjekti që sipas denoncimit janë korruptive, por nuk ka përcjellë asnjë të dhënë konkrete ose provë në lidhje me këtë pretendim dhe, në kushtet kur denoncimi është anonim, nuk ka asnjë adresë elektronike apo postare dhe as numër telefoni dhe nuk u bë i mundur kontaktimi i tij nga ana e Komisionit për t'i kërkuar informacion konkret apo dokumentacion në mbështetje të pretendimeve të tij.

9.11.2 Për të vlerësuar mbi sa pretendohet në denoncimin në fjalë, Komisioni administroi⁹⁹ dy vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të referuara në denoncim, nga të cilët rezultoi:

- **Vendimi nr. ***, datë 13.07.2015**, me palë paditëse universiteti “P” sh.p.k. dhe të paditur Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë; objekt padie: “Konstatim i pavlefshmërisë absolute dhe relative të aktit “Njoftim Vlerësimi Tatimor” i DRT-së dhe shfuqizim i vendimit të DAT (që ka lënë në fuqi aktin e DRT)”.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova; shfuqizimin e njoftimit të vlerësimit tatimor të DRT-së dhe të vendimit të DAT, objekt padie.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 20.9.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit¹⁰⁰ të bërë kundër këtij vendimi¹⁰¹.

- **Vendimi nr. ***, datë 23.3.2017**, me palë paditëse “****” sh.a. dhe të paditur Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Dibër dhe Komisioni i Ankimit pranë ISHPSHSH; objekt padie “Shfuqizim i vendimit përfundimtar të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe i vendimit të Komisionit të Ankimit të Gjobave të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Sigurimeve Shoqërore”.

Çështja është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, e cila, në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2017, ka vendosur shfuqizimin e akteve objekt padie.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2023, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.3.2023).

¹⁰⁰ Neni 50, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012: “Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi vendos: a) mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë; [...]”.

¹⁰¹ Referuar shënimit të bërë në këtë vendim.

Referuar pikës 4 të këtij vendimi, kundër tij nuk lejohet ankim, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”¹⁰².

Vlerësimi i Komisionit

9.11.3 Në vlerësimin e këtyre dy çështjeve, për të cilat është paraqitur denoncimi, Komisioni mori në konsideratë pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “*Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet*”.

Në përfundim, trupi gjykues çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se këto dy çështje subjekti i ka gjykuar në rrethana korruptive, Komisioni vlerësoi se në kushtet kur denoncuesi nuk ka përcjellë në Komision asnjë provë lidhur me pretendimet për korrupsion, ky pretendim mbetet në nivel deklarativ, i paprovuar.

9.12 Denoncim nr. * prot., datë 13.3.2023, i shtetasit K.H**

9.12.1 Denoncuesi ka qenë Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ***. Me urdhrin nr. ***, datë 16.6.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, është shkarkuar nga detyra me motivacionin se ka kryer shkelje të përsëritura të etikës, të cilat diskreditojnë figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore. Ai i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, fshirjen e masës disiplinore në dosjen e punonjësit, kthimin në vendin e mëparshëm të punës, etj.

Çështja është gjykuar nga gjyqtarja Nafije Hasko, e cila, me vendimin nr. ***, datë 10.10.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

9.12.2 Përfaqësuesit e palës së paditur në gjykatë kanë shpjeguar se paditësi në *Facebook*-un e tij personal ka bërë komente me natyrë politike dhe ka shprehur bindjet e tij, ndërkohë që ish-kryetari i Bashkisë K ishte arrestuar dhe ndaj tij po zhvillohej një proces hetimi nga prokurori.

9.12.3 Sipas denoncuesit, akti i largimit të tij nga puna është absolutisht i pavlefshëm dhe, si i tillë, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore sepse është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e parashikuar nga ligji, sipas nenit 116, shkronja “c” e Kodit të Procedurave Administrative. Sipas pretendimeve të paditësit, Prokuroria e Përgjithshme nuk ka respektuar të drejtën e informimit dhe të drejtën për t’u dëgjuar, si dhe nuk ka respektuar asnjë nga dispozitat procedurale për rastet e shkeljeve disiplinore dhe largimit nga puna.

9.12.4 Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se si provë në gjykatë nga ana e palës së paditur është paraqitur një fletë e printuar ku duken komente të rrjetit social *Facebook*, e cila është e falsifikuar,

¹⁰² Neni 45: “Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi”.

pasi komentit nuk është shkruar prej tij, por janë futur në profilin e tij duke shkruar komentin si motiv shkarkimi dhe se kjo fletë është vulosur nga Prokuroria e Përgjithshme, duke i bërë njësim me origjinalin si të ishte një dokument zyrtar i prodhuar nga një institucion shtetëror.

Ai ka pretenduar se gjyqtarja Nafije Hasko, edhe pse erdhi në dijeni të plotë se dokumenti ishte i falsifikuar, e pranoi atë si provë në kundërshtim flagrant me ligjin.

9.12.5 Subjekti i rivlerësimit, në vendimin në fjalë ka arsyetuar rastet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ dhe arsyet pse akti në fjalë nuk bënte pjesë në rastet e pavlefshmërisë absolute.

Në lidhje me pretendimin e paditësit mbi vërtetësinë e komenteve në *Facebook*, gjykata ka arsyetuar se për shkak të llojit të pavlefshmërisë që pala paditëse ka në objektin e padisë (pavlefshmeri absolute), nuk janë objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor pretendimet në lidhje me vërtetësinë dhe autorësinë e komenteve në *Facebook*, të cilat kanë shërbyer si bazë për daljen e aktit administrativ, objekt gjykimi.

Në përfundim, ka konkluduar se akti administrativ në fjalë është një akt i nxjerrë nga një organ i identifikuar, brenda kompetencave të tij dhe në formën e procedurës së parashikuar nga ligji dhe përfundimisht ka rrëzuar padinë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

9.12.6 Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse K.H janë të mbështetura në prova dhe në ligj dhe ka vendosur ndryshimin e vendimit, pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin në fjalë, detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit 12 paga mujore dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve.

Vlerësimi i Komisionit

9.12.7 Nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit rezulton se konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit objekt padie nga kjo gjykatë nuk ka ardhur për shkak të administrimit si provë të faqes së printuar të *Facebook*-ut, sikurse është pretenduar nga paditësi/denoncuesi, i cili pretendon falsitetin e saj, por për shkak të vlerësimit të aktit si të nxjerrë në kushtet e mungesës tërësore të zbatimit të procedurës, duke e vlerësuar aktin si absolutisht të pavlefshëm në interpretim të shkronjës “c” të nenit 116¹⁰³ të Kodit të Procedurave Administrative¹⁰⁴.

Në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

Bazuar në sa më lart, Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj nuk ka konstatuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe ka disponuar se nga ana e subjektit është bërë interpretim i gabuar i ligjit, duke çuar në një vendim jo të drejtë, i cili për këtë arsye u ndryshua nga ana e kësaj gjykate.

Komisioni vlerëson se disponimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me vendimin e dhënë nga subjekti ka të bëjë me themelin e çështjes, me vendimmarrjen e subjektit sa i përket themelit, gjykimi i së cilës nuk është kompetencë e Komisionit.

¹⁰³ Neni 116: “Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme: [...] c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji”.

¹⁰⁴ Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, që ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktit.

Në përfundim, trupi gjykues çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

10. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Nafije Hasko, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 28.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare